



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria-Vlada-Government*

*Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije - Ministry of finance*

---

**RREGULLORE MF - NR – 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE  
PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE**

**REGULATION MF - NR - 04/2017 ON CRITERIA, STANDARDS AND PROCEDURES  
ON PUBLIC FUNDING OF NGOs**

**UREDBA MF - BR – 04/2017 O KRITERIJUMIMA, STANDARDIMA I  
PROCEDURAMA JAVNOG FINANSIRANJA NVO**

<p><b>Ministri i Ministrisë së Financave,</b></p> <p>Në mbështetje të nenit 53, paragrafit 3, dhe të nenit 80B të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-222, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin 05/L-007, të nenit 8, paragrafi 1.4. të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dhe të Vendimit Nr. 05/89 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e datës 25.05.2016, nxjerr këtë:</p> <p><b>RREGULLORE MF - NR – 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE</b></p> <p><b>KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p><b>Neni 1</b> <b>Qëllimi</b></p> <p>Kjo Rregullore përcakton kriteret, standardet dhe procedurat themelore për financimin publik të organizatave jo-qeveritare (këtu e tutje OJQ), me qëllim të vendosjes së një sistemi transparent dhe llogaridhënës për financimin me fonde publike të programeve dhe projekteve të OJQ-ve që janë të interesit publik të në Republikën e Kosovës.</p>	<p><b>Minister of Ministry of Finance,</b></p> <p>Pursuant to Article 53, paragraph 3 and Article 80 B of the Law No. 03 / L-048 on Public Finance Management and Accountability, amended and supplemented by Law no. 03 / L-222, law no. 04 / L-116 and law no. 04 / L-194, Article 8, paragraph 1.4. of Regulation no. 02/2011 on the Areas of Administrative Responsibilities of the Prime Minister’s Office and Ministries, and based on the decision no. 05/89 of the Government of Republic of Kosovo dated 25. 05. 2016, issues the following:</p> <p><b>REGULATION MF - NR - 04/2017 ON CRITERIA, STANDARDS AND PROCEDURES ON PUBLIC FUNDING OF NGOS</b></p> <p><b>CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</b></p> <p><b>Article 1</b> <b>Scope</b></p> <p>This regulation defines criteria, standards and basic procedures for public funding of non-governmental organizations (hereinafter NGOs), with the purpose of establishing a transparent and accountable system, for financing with public funds programs and projects pertaining to the public interest of non-governmental organizations in Kosovo.</p>	<p><b>Ministar Ministarstva Finansija,</b></p> <p>Na osnovu lana 53. stav 3. i lana 80 iz Zakona br. 03/L-048 o upravljanju javnim finansijama i odgovornostima, izmenjeno i dopunjeno Zakonom br. 03/L-222, Zakona br. 04/L-116, Zakona br. 04/L-194, Zakona br. 05/L-063 i Zakona 05/L-007, lan 8, stav 1.4. Uredbe br. 02/2011 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije Premijera i Ministarstava, i Odluke br. 05/89 Vlade Republike Kosova od dana 25.05.2016, izdaje:</p> <p><b>UREDBA MF - BR – 04/2017 O KRITERIJUMIMA, STANDARDIMA I PROCEDURAMA JAVNOG FINANSIRANJA NVO</b></p> <p><b>POGLAVLJE I</b> <b>OPŠTE ODREDBE</b></p> <p><b>lan 1</b> <b>Cilj</b></p> <p>Ova Uredba utvr uje kriterijume, standarde i osnovne procedure za javno finansiranje nevladinih organizacija (u daljem tekstu NVO), sa ciljem uspostavljanja transparentnog i odgovornog finansiranja iz javnih fondova za programe i projekte NVO koji su od javnog interesa u okviru Republike Kosova.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b> <b>Fushëveprimi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2</b> <b>Scope</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>lan 2</b> <b>Oblast delovanja</b></p>
<p>1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga çdo organizatë buxhetore e cila financon projektet dhe programet e OJQ-ve të cilat janë aplikues apo partner në aplikimet, sipas një thirrje publike për financim të projekteve dhe programeve të OJQ-ve, dhe të cilat i plotësojnë kriteret sipas kësaj Rregulloreje.</p> <p>2. Dispozitat e Rregullores aplikohen përshtatshmërisht edhe për mbështetjen publike jo-financiare për OJQ-të, duke përfshirë pronat publike qendrore dhe komunale dhe çfarëdo mbështetje tjetër jo-financiare e cila, sipas vlerësimit të organizatës buxhetore, duhet të kalojë përmes një procesi konkurrues. 3.</p> <p>3. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen edhe nga shpërndarësit jo publik të fondeve publike, në rastet kur ata bëjnë shpërndarjen e fondeve publike për OJQ-të si pjesë e ndonjë marrëveshje me organizatat buxhetor.</p> <p>4. Dispozitat e kësaj Rregulloreje nuk zbatohen për dhënien në shfrytëzim ditor të pronave publike qendrore apo komunale për realizimin e aktiviteteve të OJQ-ve, duke përfshirë dhënien në shfrytëzim të sallave, pajisjeve apo mjeteve të ngjashme për organizim të aktiviteteve ditore.</p>	<p>1. The provisions of this Regulation are implemented by each budgetary organization, which funds projects and programs for NGOs that are applicants or partner during the application according to a call for proposals for funding projects and programmes from NGOs, which meet the criteria according to this regulation.</p> <p>2. Provisions of the Regulation apply mutatis mutandis also to the public non-financial support for NGOs, including central and municipal public properties and any other non-financial support which, according to the budget organization must pass through a competitive process.</p> <p>3. The provisions of this Regulation are implemented by non-public distributors of public funds, in cases when they make the distribution of public funds to NGOs as part of any agreement with budgetary organizations.</p> <p>4. The provisions of this Regulation do not apply to outsource for daily use of central or municipal public property for implementing NGO activities, including giving for use rooms, devices or similar equipment for organizing daily activities.</p>	<p>1. Odredbe ove Uredbe se primenjuju od strane svake organizacije koja finansira projekte i programe NVO koje se prijavljuju ili su partneri prilikom apliciranja, navodi se u javnom pozivu za finansiranje projekata i programa NVO, a koje ispunjavaju kriterijume iz ove Uredbe.</p> <p>2. Odredbe ove Uredbe se primenjuju mutatis mutandis i za javnu ne-finansijsku podršku za nevladine organizacije, uklju uju i i centralnu i opštinsku javnu imovinu i bilo koji drugi vid ne-finansijske podrške koja, prema proceni budžetske organizacije mora da pro e kroz proces nadmetanja.</p> <p>3. Odredbe ove Uredbe se sprovode i od strane distributera javnih fondova koji ne predstavljaju javne institucije, kada iste sprovode distribuciju javnih sredstava za NVO u okviru bilo kog dogovora sa budžetskim organizacijama.</p> <p>4. Odredbe ove Uredbe se ne odnose na dnevno izdavanje centralne ili lokalne javne imovine za realizaciju aktivnosti nevladinih organizacija, uklju uju i i ugovaranje prostorija, opreme ili sli nih ure aja za organizovanje svakodnevnih aktivnosti.</p>

<p>5. Dispozitat kësaj e Rregulloreje nuk zbatohen për rastet e mbështetjes financiare të drejtpërdrejta për OJQ-të, e cila mbështetje nuk tejkalon shumën prej pesëqind (500 €) euro për një OJQ, si dhe:</p> <p>5.1. shuma e të gjitha përkrahjeve të tilla të drejtpërdrejta nuk tejkalon shumën prej pesë për qind (5%) të ndarjes totale buxhetore në kuadër të kodit/programit buxhetor për vitin përkatës fiskal, në rastet kur shuma totale në kuadër të atij kodi/programi buxhetor është deri në njëqind mijë (100,000.00 €) euro;</p> <p>5.2. shuma e të gjitha përkrahjeve të tilla të drejtpërdrejta nuk tejkalon shumën prej dy për qind (2%) të ndarjes totale buxhetore në kuadër të kodit/programit buxhetor për vitin përkatës fiskal, në rastet kur shuma total e në kuadër të atij kodi/programi buxhetor nga njëqind mijë e një (100,001 €) euro deri në një milion (1,000,000.00 €) euro; dhe</p> <p>5.3. shuma e të gjitha përkrahjeve të tilla të drejtpërdrejta nuk tejkalon shumën prej një për qind (1%) të ndarjes totale buxhetore në kuadër të kodit/programit buxhetor për vitin përkatës fiskal, në rastet kur shuma total e në kuadër të atij kodi programi është mbi një milion (1,000,000.00 €) euro.</p> <p>6. Përjashtimisht nga paragrafi 5 i këtij neni, në rastin e ofrimit të mbështetjes financiare sipas paragrafit 5, ofruesi i mbështetjes financiare lidh kontratë me OJQ-në përfituese dhe duhet të respektojë standardet themelore të</p>	<p>5.The provisions of this Regulation do not apply to cases of direct financial support to NGOs, which does not exceed the amount of five hundred (€500) Euro for an NGO as well as:</p> <p>5.1. the amount of all such direct support do not exceed five percent (5%) of the total budget allocated under the budget code / program for the corresponding fiscal year, in cases when the total amount under that code / budget program is up to hundred thousand (€100,000.00) euros;</p> <p>5.2. the amount of all such direct supports do not exceed one percent (1%) of the total budget allocated under the budget code / program for the corresponding fiscal year, in cases when the total amount under that code/ budget program from one hundred thousand and one euros (€100,001) up to one million (€1,000,000.00) euros.</p> <p>5.3. the amount of all such direct support does not exceed the amount of one percent (1%) of the total budget allocation within the budget code / program for the relevant fiscal year, when the total amount within that program code is above One million (1,000,000.00 €) euro.</p> <p>6. Exceptionally from paragraph 5 of this Article, in case of providing financial support under paragraph 5, the financial support provider concludes a contract with the beneficiary NGO and must comply with the</p>	<p>5. Odredbe ove Uredbe se ne primenjuju na slu ajeve direktne finansijske podrške NVO, ija podrška ne prelazi iznos od pet stotina (500 €) evra za NVO, kao i:</p> <p>5.1. zbir itave tako usmerene podrške ne prelazi pet odsto (5%) od ukupnog budžeta raspodele u okviru budžetskog koda/ programa za odgovarajucu fiskalnu godinu, kada ukupan iznos u okviru tog koda / budžetskog programa iznosi do sto hiljada (100.000,00 €) evra;</p> <p>5.2. zbir itave takve direktne podrške ne prelazi dva odsto (2%) od ukupnog budžeta raspodele u okviru budžetskog koda/programa za odgovaraju u fiskalnu godinu, kada ukupan iznos u okviru tog koda/-budžetskog programa iznosi od sto hiljada i jedan (100.001,00 €) evra; i</p> <p>5.3. zbir itave takve direktne podrške ne prelazi jedan odsto (1%) od ukupnog budžeta raspodele u okviru budžetskog koda/programa za odgovaraju u fiskalnu godinu, kada ukupan iznos u tom programskom kodu iznosi preko milion (1,000,000.00 €) evra.</p> <p>6. Izuzetno od stava 5 ovog lana, u slu aju pružanja finansijske podrške iz stava 5, davalac finansijska podrška zaklju uje ugovor sa korisnikom NVO i mora biti u skladu sa osnovnim standardima finansiranja koji se</p>
---	---	---

<p>financimit, lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.</p> <p>7. Dispozitat e Rregullores nuk zbatohen edhe për mbështetjen financiare publike që jepet në gjendje të jashtëzakonshme siç parashihet me legjislacionin në fuqi, kur është e pamundur të pritet për të zhvilluar një thirrje publike në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje.</p> <p>8. Dispozitat e kësaj Rregulloreje nuk aplikohen për thirrjet e publikuara para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.</p>	<p>basic financing standards related to contracting, monitoring, publication and reporting under the provisions of this Regulation.</p> <p>7. The provisions of the Regulation do not apply also to public financial support given to the state of emergency as required by applicable law, when it is impossible to expect to make a public announcement in accordance with the requirements of this Regulation.</p> <p>8. The provisions of this Regulation do not apply to the calls published before this Regulation enters into force.</p>	<p>odnose na ugovaranje, pracenje, objavljivanje i izvještavanje u skladu sa odredbama ove Uredbe.</p> <p>7. Odredbe ove Uredbe se ne odnose i na javnu finansijsku podršku koja je data tokom vanrednog stanja u skladu sa važećim zakonom, kada je nemoguće o ekvivalenti objavljivanje javnog obaveštenja u skladu sa zahtevima ove Uredbe.</p> <p>8. Odredbe ove Uredbe se ne odnose na pozive objavljene pre stupanja na snagu ove Uredbe.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 3</b> <b>Përkufizimet</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3</b> <b>The definitions</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Ian 3</b> <b>Definicije</b></p>
<p>1. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, përkufizimet në vazhdim kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. <b>Burimet publike të financimit</b> - nënkupton të gjitha fondet e ndara në kuadër të buxhetit të Republikës së Kosovës për organizatat buxhetore, përfshirë këtu edhe fondet nga burimet e huaja të cilat menaxhohen nga organizatat buxhetore, me kusht nuk është arritur ndonjë marrëveshje e veçantë e cila përcakton modalitete dhe procedura të veçanta të menaxhimit të tyre;</p> <p>1.2. <b>Mbështetje financiare</b> – nënkupton çdo formë e mbështetjes për OJQ-të, e cila shprehet në vlerë monetare, pa marrë</p>	<p>1. For the purposes of this Regulation, the following definitions shall have the following meaning:</p> <p>1.1. <b>Public sources of funding</b> - means all funds allocated within the budget of the Republic of Kosovo for budgetary organizations, including funds from foreign sources that are managed by budgetary organizations, with the condition that there hasn't been reached any special agreement which defines the modalities and specific procedures of their management;</p> <p>1.2. <b>Financial support</b> - means every form of support to NGOs, which is expressed in monetary value, regardless of its</p>	<p>1. Za svrhu ove Uredbe, definicije u nastavku imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. <b>Javni izvori finansiranja</b> – podrazumevaju se sva sredstva/fondovi izdvojeni u budžetu budžetskih organizacija Republike Kosovo, uključujući i sredstva iz stranih izvora kojima upravljaju budžetske organizacije, pod uslovom da ne postoji bilo kakav poseban ugovor koji definiše modalitete i posebne procedure njihovog upravljanja;</p> <p>1.2. <b>Finansijska podrška</b> – podrazumeva se bilo koji oblik podrške NVO, koja je izražena u nov anoj vrednosti, bez obzira</p>

<p>parasysh emërtimin e saj;</p> <p>1.3. <b>Mbështetje jo-financiare</b> – nënkupton mbështetjen jo-financiare për OJQ-të përmes ofrimit të pronave publike qendrore dhe komunale, dhe format e tjera të mbështetjes që nuk jepen në vlerë monetare;</p> <p>1.4. <b>Ofruesi i mbështetjes financiare</b> – nënkupton organizatat buxhetore që disponon burime publike të financimit;</p> <p>1.5. <b>Aplikues</b> – nënkupton OJQ-në vendore apo të huaj, e regjistruar në Republikën e Kosovës në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare, ose në regjistrin e organizatave jo qeveritare në shtetet e huaja ku është e koncentruar diaspora kosovare, e cila ka aplikuar për mbështetje financiare në kuadër të ndonjë thirrje publike për mbështetje financiare për OJQ-të;</p> <p>1.6. <b>Përfitues</b> – nënkupton OJQ-në vendore apo të huaj, e regjistruar në Republikën e Kosovës në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare, ose në regjistrin e organizatave jo qeveritare në shtetet e huaja ku është e koncentruar diaspora kosovare, ose organizatat tjera dhe partnerët të cilët janë kontraktuar sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje;</p>	<p>denomination;</p> <p>1.3. <b>Non-financial support</b> – means non-financial support to NGOs by providing the central and municipal public properties, and other forms of support that is not given in monetary value;</p> <p>1.4. <b>Provider of financial support</b> – means the budgetary organizations that possess public sources of funding;</p> <p>1.5. <b>Applicant</b> – means a local or foreign NGO registered in the Republic of Kosovo in accordance with the provisions of the applicable legislation on freedom of association in non-governmental organizations, or in the register of non-governmental organizations in foreign countries where Kosovar diaspora is concentrated, which has applied for financial support in the framework of a public call for financial support for NGOs;</p> <p>1.6. <b>Beneficiary</b> – means a local or foreign NGO, registered in the Republic of Kosovo in accordance with the provisions of the applicable legislation on freedom of association in non-governmental organizations, or in the register of non-governmental organizations in foreign countries where Kosovar diaspora is concentrated or other organizations and partners that are contracted under the provisions of this Regulation;</p>	<p>na njen naziv;</p> <p>1.3. <b>Ne-finansijska podrška</b> – podrazumeva se ne-finansijska podrška nevladinim organizacijama kroz pružanje centralne i opštinske javne imovine, i drugi oblici podrške koji nisu dati u nov anoj vrednosti;</p> <p>1.4. <b>Davalac finansijske podrške</b> – podrazumevaju se budžetske organizacije koje imaju dostupne javne izvore finansiranja;</p> <p>1.5. <b>Podnosilac</b> – je domaca ili strana nevladina organizacija registrovana u Republici Kosova u skladu sa odredbama zakona o slobodi udruživanja u nevladinim organizacijama, ili u registar nevladinih organizacija u inostranstvu gde je koncentrisana kosovska dijaspora, koja je podnela zahtev za finansijsku podršku u okviru javnog poziva za finansijsku podršku NVO;</p> <p>1.6. <b>Korisnik</b> – podrazumeva se domaca ili strana NVO registrovana u Republici Kosovo u skladu sa odredbama zakona o slobodi udruživanja u nevladinim organizacijama, ili u registar nevladinih organizacija u inostranstvu gde je koncentrisana kosovska dijaspora ili drugim organizacijama i partnerima koji su ugovoreni u skladu sa odredbama ove Uredbe;</p>
---	---	--

<p>1.7. <b>Programet dhe projektet e interesit publik</b> – nënkupton grupin apo grupet të aktiviteteve të përcaktuara qartë tematikisht të cilat janë në përputhje me vlerat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe zbatimi i të cilave përmes veprimeve afatgjata (programeve) apo afatshkurtra (projekteve) sjell një vlerë të dukshme të shtuar shoqërore e cila ndikon në rritjen e cilësisë së jetës në përgjithësi dhe nxit zhvillimin e gjerë të komunitetit;</p> <p>1.8. <b>Veprimtaria për përfitim të publikut</b> – nënkupton veprimtaritë për të mirën e publikut të cilat janë të parapara me legjislacionin në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare.</p> <p>1.9. <b>Distribues jo-publik</b> –nënkupton çdo kontraktor, duke përfshirë bizneset dhe OJQ-të, i cili mbi bazën e një marrëveshje me ofruesit e mbështetjes financiare publike ka marrë përsipër të bëjë shpërndarjen e mbështetjes financiare publike për OJQ-të.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 4 Parimet e përgjithshme</b></p> <p>1. Financimi publik i OJQ-ve nga ana e ofruesit të mbështetjes financiare bëhet duke u bazuar në parimet si në vijim:</p> <p>1.1. Konkurrueshmëria;</p>	<p>1.7. <b>Programs and projects of public interest</b> – means a group or groups of activities defined clearly and thematically, which are in accordance with the values set in the Constitution of the Republic of Kosovo and the implementation of which through long-acting (programs) or short-term (project), brings an apparent and added social value impacting the increase of life quality in general and promotes the wider development of community;</p> <p>1.8. <b>Activities for public benefit</b> – means the activities for the public good which are envisaged by applicable legislation on freedom of association in non-governmental organizations.</p> <p>1.9. <b>Non-public distributor</b> – means any contractor, including businesses and NGOs, which on the basis of an agreement with providers of public financial support has taken over the allocation of public financial support for NGOs.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4 General principles</b></p> <p>1. Public financing of NGOs by providers of financial support is done based on the following principles:</p> <p>1.1. Competitiveness;</p>	<p>1.7. <b>Programi i projekti od javnog interesa</b> – podrazumeva se grupa ili sklop aktivnosti tematski definisanih a koje u skladu sa vrednostima sadržanim u Ustavu Republike Kosovo i ija implementacija kroz dugoro ne aktivnosti (programi) ili kratkoro ne aktivnosti (projekti) donosi osetno povecanu društvenu vrednost što povecava kvalitet života uopšte i promovise širi razvoj zajednice;</p> <p>1.8. <b>Delovanje u korist javnosti</b> – označava aktivnosti za dobrobit javnosti koje su predviđene zakonom o slobodi udruživanja u nevladinim organizacijama.</p> <p>1.9. <b>Ne-javni distributer</b> – označava svakog izvođača, uključujući i kompanije i nevladine organizacije, koje na osnovu ugovora sa davaocima javne finansijske podrške preuzimaju dodelu javne finansijske podrške za nevladine organizacije.</p> <p style="text-align: center;"><b>lan 4 Opšti principi</b></p> <p>1. Javno finansiranje NVO od strane subjekata koji dodeluju finansijsku podršku zasniva se na sledecim principima:</p> <p>1.1. Konkurentnost;</p>
--	--	---

<p>1.2. Trajtimi i barabartë dhe mos-diskriminimi i aplikuesve si dhe gjithë-përfshirja gjinore e përfituesve</p> <p>1.3. Transparenca në procedura dhe vendim marrje në gjithë ciklin e ofrimit të mbështetjes financiare, duke përfshirë publikimin e kriterëve dhe procedurave, aplikimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e përfituesve;</p> <p>1.4. Kriete të caktuara më parë të cilat do të mundësojnë vlerësimin e propozimeve të aplikuesve kundrejt objektivave dhe prioritetëve të mbështetjes financiare;</p> <p>1.5. Parimi i efektivitetit dhe i ekonomizimit në shfrytëzimin e fondeve publike, duke siguruar që të arrihen objektivat dhe prioritetet e parapara me një kosto sa më të favorshme për shoqërinë;</p> <p>1.6. Respektimi i plotë të parimeve të llogaridhënies, dhe raportimit në shfrytëzimin e fondeve publike;</p> <p>1.7. Financim përmes fondeve publike të projekteve dhe programeve që janë me prioritet për Republikën e Kosovës dhe në interes të publikut;</p> <p>1.8. Ruajtjen e pavarësisë së përfituesve;</p> <p>1.9. Parandalimin të çfarëdo konflikti të interesit;</p>	<p>1.2. Equal treatment and non-discrimination of applicants as well as all gender inclusion of beneficiaries;</p> <p>1.3. Transparency in procedures and decision-making throughout the entire cycle of financial support, including the publication of criteria and procedures, application, decision-making and selection of beneficiaries;</p> <p>1.4. Predetermined criteria which will enable the evaluation of proposals from applicants towards the objectives and priorities of financial support;</p> <p>1.5. The principle of effectiveness and economization on the use of public funds, to ensure the achievement of objectives and priorities set by most favourable cost for the society;</p> <p>1.6. Ensuring full respect to the principles of accountability, and reporting on use of public funds;</p> <p>1.7. Financing through public funds to projects and programs that are of priority for the Republic of Kosovo and of public interest;</p> <p>1.8. Retain the independence of beneficiaries;</p> <p>1.9. Prevent any conflict of interest;</p>	<p>1.2. Jednak tretman i nediskriminacija kandidata kao i rodna jednakost korisnika</p> <p>1.3. Transparentnost u proceduri i donošenje odluka tokom ciklusa dodele finansijske podrške, uklju uju i objavljivanje kriterijuma i procedura, aplikacije, donošenje odluka i odabir korisnika;</p> <p>1.4. Utvr eni kriterijumi koji ce omoguciti procenu predloga aplikanaata u odnosu na ciljeve i prioritete finansijske podrške;</p> <p>1.5. Princip efikasnosti i štednje prilikom korišćenja javnih sredstava, obezbe uju i da se postignu ciljevi i prioriteti koji su predvi eni po troškovima koji su povoljniji za društvo;</p> <p>1.6. Puno poštovanje principa odgovornosti i izveštavanja o korišćenju javnih sredstava;</p> <p>1.7. Finansiranje iz javnih fondova za projekte i programe koji su prioritet za Republiku Kosovo i u javnom interesu;</p> <p>1.8. O uvanje nezavisnosti korisnika;</p> <p>1.9. Spre avanje svakog vida sukoba interesa;</p>
---	---	--



<p>1.10. Sigurimin e dy-shkallshmërisë në trajtimin e ankesave të aplikantëve; dhe</p> <p>1.11. Parandalimin e financimit të çfarëdo aktiviteti të subjekteve politike.</p> <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI II</b> <b>KRITERET PËR FINANCIMIN PUBLIK</b> <b>TË OJQ-VE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Planifikimi i mbështetjes financiare</b></p> <p>1. Ofruesit e mbështetjes financiare planifikojnë mbështetjen financiare në kuadër të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës, në linjë me prioritetet dhe objektivat strategjike dhe në konsultim me shoqërinë civile.</p> <p>2. Ofruesit e mbështetjes financiare mund të japin mbështetje financiare vetëm në fushën e veprimtarisë dhe përgjegjësisë së tyre.</p> <p>3. Ministria e Financave krijon kod ekonomik të veçantë për secilën organizatë buxhetor – program, në kuadër të të cilit duhet të planifikohet mbështetja financiare për OJQ-të.</p> <p>4. Organizatat buxhetore të cilat nuk i plotësojnë kushtet e parapara në paragrafin 1 dhe 2 këtij neni nuk mund të ofrojnë mbështetje financiare për OJQ-të.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b></p>	<p>1.10. Ensuring a two-step handling of applicants ‘complaints; and</p> <p>1.11. Prevent funding any activity of political parties.</p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER II</b> <b>CRITERIA FOR PUBLIC FUNDING THE</b> <b>NGOs</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Planning of financial support</b></p> <p>1. Providers of financial support should plan the financial support within the annual budget of the Republic of Kosovo, in line with strategic priorities and objectives and in consultation with civil society.</p> <p>2. Providers of financial support can give the financial support only in the field of their activity and responsibility.</p> <p>3. Ministry of Finance creates a special economic code for each budget organization - program, in the framework of which financial support should be planned for NGOs.</p> <p>4. Budgetary Organizations that do not meet the conditions specified in paragraph 1 and 2 of this article cannot provide financial support for NGOs.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 6</b></p>	<p>1.10. Obezbediti dvostepeni sistem za rešavanje pritužbi aplikanata/podnosioca; i</p> <p>1.11. Prevencija finansiranja bilo koje aktivnosti političkih stranaka.</p> <p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE II</b> <b>KRITERIJUMI ZA JAVNO</b> <b>FINANSIRANJE NVO</b></p> <p style="text-align: center;"><b>lan 5</b> <b>Planiranje finansijske podrške</b></p> <p>1. Davaoci finansijske podrške planiraju tu finansijsku podršku u okviru godišnjeg budžeta Republike Kosovo, u skladu sa strateškim prioritetima i ciljevima i uz konsultacije sa civilnim društvom.</p> <p>2. Davaoci finansijske podrške mogu pružiti finansijsku podršku samo u okviru svoje oblasti aktivnosti i odgovornosti.</p> <p>3. Ministarstvo finansija kreira poseban ekonomski kod za svaku budžetsku organizaciju - program, pod kojima finansijska podrška treba da bude planirana za NVO.</p> <p>4. Organizacije koje ne ispunjavaju uslove iz stava 1. i 2. ovog lana ne mogu da obezbede finansijsku podršku za NVO.</p> <p style="text-align: center;"><b>lan 6</b></p>
---	---	---

<b>Plani vjetor i mbështetjes financiare</b>	<b>Annual plan of financial support</b>	<b>Godišnji plan finansijske podrške</b>
<p>1. Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës,</p> <p>2. Plani vjetor i mbështetjes financiare për OJQ-të përmban:</p> <p>1.1. informata për organizatën buxhetore;</p> <p>1.2. shumën e mbështetjes financiare për vitin fiskal;</p> <p>1.3. fushën/fushat në të cilat do të ofrohet mbështetja financiare për OJQ</p> <p>1.4. objektivat e mbështetjes financiare;</p> <p>1.5. numrin e përafërt të organizatave që do të përfitojnë;</p> <p>1.6. kohën e hapjes së thirrjes për aplikime; dhe</p> <p>1.7. kohën e përafërt të fillimit të zbatimit të projekteve/programeve përfituese.</p> <p>2. Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, përgatit planin përmbledhës vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të dhe e</p>	<p>1. Providers of financial support should prepare the annual plan of financial support for NGOs at the latest 30 days after the approval of the annual budget of the Republic of Kosovo and should send it to respective office for good governance at the Prime Minister's Office of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The annual plan of financial support for NGOs include:</p> <p>1.1. Information about the budgetary organization;</p> <p>1.2. the amount of financial support for the fiscal year;</p> <p>1.3. the area / areas on which the financial support for NGOs will be provided;</p> <p>1.4. the objectives of financial support;</p> <p>1.5. the approximate number of organizations that will benefit;</p> <p>1.6. The opening time of the call for applications; and</p> <p>1.7. Approximate time for starting the implementation of beneficiary projects / programs</p> <p>2. The Prime minister's Office of the Republic of Kosovo, through the relevant Office for Good Governance, prepares the summary</p>	<p>1. Davaoci finansijske podrške pripremaju godišnji plan finansijske podrške za NVO najkasnije 30 dana nakon usvajanja godišnjeg budžeta Republike Kosova i dostavljaju doti noj kancelarijiza dobru vladavinu pri Kancelariji premijera Republike Kosovo.</p> <p>2. Godišnji plan finansijske podrške za NVO sadrži:</p> <p>1.1. informacije o budžetskoj organizaciji;</p> <p>1.2. iznos finansijske podrške za fiskalnu godinu;</p> <p>1.3. oblast/oblasti u kojima ce biti pružena finansijska podrška za NVO ;</p> <p>1.4. ciljevi finansijske podrške;</p> <p>1.5. približan broj organizacija kao mogućih korisnika;</p> <p>1.6. vreme otvaranja poziva za dostavu predlog aplikacija; i</p> <p>1.7. približno vreme po etka sprovo enja projekata/programa od strane korisnika.</p> <p>2. Kancelarija premijera Republike Kosovo, preko odgovaraju e Kancelarije za dobro upravljanje, priprema zbirni godišnji plan</p>

<p>publikon në faqen e saj elektronike, më së largu pas dyzet e pesë (45) ditëve pas miratimit të buxhetit të Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Secili ofrues i mbështetjes financiare duhet të publikojë në ueb faqen e vet pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të që ka të bëjë me atë institucion, më së largu pas dyzet e pesë (45) ditëve pas miratimit të buxhetit të Republikës së Kosovës.</p>	<p>annual plan of financial support for NGOs and publishes it on its website, at latest forty five (45) days after the budget approval of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. Each provider of financial support should publish on its website the annual plan of financial support for NGOs concerning that institution, at latest forty five (45) days after the budget approval of the Republic of Kosovo.</p>	<p>finansijske podrške za NVO i objavljuje na svojoj internet stranici, najkasnije etrdeset pet (45) dana nakon usvajanje budžeta Republike Kosovo</p> <p>3. Svaki davalac finansijske podrške treba da objavi na svojoj internet stranici godišnji plan finansijske podrške za NVO koje ima veze sa tom institucijom, najkasnije etrdeset pet (45) dana nakon usvajanje budžeta Republike Kosovo</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Kapacitetet institucionale</b></p> <p>1. Çdo ofrues i mbështetjes financiare që planifikon mbështetje financiare për OJQ-të duhet të disponojnë me kapacitete institucionale, duke përfshirë burimet e nevojshme njerëzore për të zbatuar kërkesat e kësaj Rregulloreje.</p> <p>2. Ofruesi i mbështetjes financiare duhet të themelojë Komisionin Vlerësues, i cili do të merret me vlerësimin e aplikimeve sipas thirrjes publike dhe të bëjë përzgjedhjen e përfituesve.</p> <p>3. Ofruesi i mbështetjes financiare duhet të themelojë Komisionin e Ankesave, i cili do të merret me trajtimin e ankesave eventuale të aplikantëve.</p> <p>4. Ofruesi i mbështetjes financiare duhet të emërojë zyrtarin përgjegjës apo të themelojë ekip të veçantë për secilën kontratë të lidhur</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Institutional capacities</b></p> <p>1. Each provider of financial support planning financial support for NGOs must have institutional capacities, including human resources needed to implement the requirements of this Regulation.</p> <p>2. The provider of financial support should establish an Evaluation Committee, which will deal with the assessment of applications according to the public call and make the selection of beneficiaries.</p> <p>3. Provider of financial support should establish a Complaints Commission, which will deal with the complaints of potential applicants.</p> <p>4. Provider of financial support shall appoint a responsible official or establish a separate team for each contract concluded with beneficiary</p>	<p style="text-align: center;"><b>Ian 7</b> <b>Institucionalni kapaciteti</b></p> <p>1. Svaki davalac finansijske podrške koji planira finansijsku podršku za NVO bi trebalo da raspolaže institucionalnim kapacitetima, uklju uju i i ljudske resurse potrebne za ispunjenje zahteva iz ove Uredbe.</p> <p>2. Davalac finansijske podrške treba da uspostavi Komisiju za procenu, koja ce se baviti procenom prijava u okviru javnog poziva i izvršiti izbor korisnika.</p> <p>3. Davalac finansijske podrške treba da formira Komisiju za žalbe, koji ce se baviti mogucim pritužbama podnosilaca prijava.</p> <p>4. Pružalac finansijske podrške imenuje odgovornog službenika ili utvr uje poseban tim za svaki ugovor zaklju en sa korisnikom</p>

<p>me OJQ-të përfituese, me qëllim të monitorimit të zbatimit të projektit/programit si dhe vlerësimit të përmbushjes së objektivave dhe arritjes së rezultateve të parapara.</p> <p>5. Ofruesi i mbështetjes financiare duhet të sigurojë përkrahjen e nevojshme për Komisionin Vlerësues, Komisionin e Ankesave dhe zyrtarin apo ekipin për monitorimin e zbatimit të kontratës, duke siguruar burimet e nevojshme financiare dhe administrative për zbatimin e suksesshëm të thirrjes publike dhe për monitorim dhe vlerësim të mbështetjes financiare.</p>	<p>NGOs, in order to monitor the implementation of the project / program as well as to evaluate the fulfilment of objectives and achievement of envisaged results.</p> <p>5. Provider of financial support should give necessary support to the Evaluation Committee, Complaints Committee and to the officer or the team for monitor the implementation of the contract, ensuring necessary financial and administrative resources for successful implementation of the Public Call and for monitoring and evaluation of financial support.</p>	<p>NVO, da prati realizaciju projekta/programa i sprovodi evaluaciju ispunjavanja ciljeva i postizanja predvi enih rezultata.</p> <p>5. Davalac finansijske podrške treba da obezbedi neophodnu podršku Komisiji za procenu, Žalbenoj komisiji i službeniku ili timu za pracenje/monitoring implementacije ugovora, obezbediti neophodna finansijska sredstva i administrativnu podršku za uspešnu implementaciju javnog poziva i monitoring i evaluaciju finansijske podrške.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Komisioni Vlerësues</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Evaluation Committee</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Ian 8</b> <b>Komisija za procenu</b></p>
<p>1. Secili ofruer i mbështetjes financiare që ka shpallur thirrje publike për mbështetje financiare, themelon Komisionin Vlerësues, i përbërë nga anëtarët që kanë përvojë dhe integritet, me mandat për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve.</p> <p>2. Përbërja e komisionit, kohëzgjatja dhe mandati i tij caktohet me vendim të zyrtarit kryesor administrativ, përkatësisht udhëheqësit të organizatës/institucionit.</p> <p>3. Komisioni Vlerësues përbëhet nga pesë (5) anëtar, si në vijim:</p> <p>3.1. një përfaqësues nga njësia përkatëse, në kuadër të të cilës është planifikuar</p>	<p>1. Each provider of financial support that has published a public call for financial support, establishes the Evaluation Committee, consisting of members who have experience and integrity, with a mandate to review and evaluate applications.</p> <p>2. The Committee composition, duration and its mandate is assigned by the decision of the chief administrative officer, or by the head of organization / institution.</p> <p>3. The Evaluation Committee consists of five (5) members, as follows:</p> <p>3.1. a representative from the relevant unit, under which the financial support is planned;</p>	<p>1. Svaki davalac finansijske podrške koji je objavio javni poziv za finansijsku podršku, treba da uspostavi Komisiju za procenu sastavljen od lanova koji imaju iskustvo i integritet sa zadatkom da preispita i proceni predlog projekte.</p> <p>2. Sastav komisije, trajanje i mandat se odre uju odlukom glavnog administrativnog službenika, ili rukovodioca organizacije/institucije.</p> <p>3. Komisija za procenu se sastoji od pet (5) lanova, po sledecem:</p> <p>3.1. predstavnik iz odgovarajućeg jedinice, u okviru koje je planirana finansijska</p>

<p>mbështetja financiare;</p> <p>3.2. dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, njëri nga të cilët duhet të jetë përfaqësues i OJQ-ve, të cilët do të zgjidhen përmes një thirrje publike të cilën do ta bëjë ofruesi i mbështetjes financiare;</p> <p>3.3. dy përfaqësues nga institucioni që ofron mbështetjen financiare, njëri nga të cilët duhet të jetë nga njësia përkatëse për buxhet/financa.</p> <p>4. Përveç anëtarëve të rregullt të Komisionit Vlerësues nga paragrafi 3 i këtij neni, ofruesi i mbështetjes financiare duhet të parasheh me vendim edhe një (1) anëtarë rezervë, i cili do të zëvendësojë në rast nevojë anëtarin e Komisionit Vlerësues i cili ka konflikt interesi.</p> <p>5. Komisioni Vlerësues themelohet gjatë kohës sa thirrja publike është e hapur dhe emrat e anëtarëve të Komisionit Vlerësues bëhen publik brenda shtatë (7) ditëve pas themelimit të Komisionit.</p> <p>6. Komisioni Vlerësues në mbledhjen e tij të parë miraton rregullat e punës, përmes të cilave do të udhëhiqet puna në komision dhe këto rregulla bëhen publike brenda shtatë (7) ditëve pas miratimit</p> <p>7. Anëtarë të komisionit vlerësues nuk mund të jenë të emëruarit politik.</p>	<p>3.2. two representatives from the group of external experts, one of whom shall be a representative of NGOs, which will be selected through a public call done by the provider of financial support;</p> <p>3.3. two representatives from the institution providing financial support, one of which must be from relevant budget / finance department.</p> <p>4. Besides regular members of the Evaluation Committee as specified in paragraph 3 of this Article, the provider of financial support should foresee by decision also one (1) backup member, who will replace if necessary any member of the Evaluation Committee who has a conflict of interest.</p> <p>5. The Evaluation Committee is established during the period when the public call is open and the names of the members of the Evaluation Committee become public within seven (7) days after the establishment of Committee.</p> <p>6. The Evaluation Committee at its first meeting approves the working rules, through which the work will be led by the Committee and these rules are made public within seven (7) days after the approval.</p> <p>7. Members of the evaluation committee cannot be political appointees.</p>	<p>podrška;</p> <p>3.2. dva predstavnika iz grupe spoljnih eksperata, od kojih jedan mora da bude predstavnik NVO-a, koji ce biti izabrani putem javnog poziva kojeg objavljuje davalac finansijske podrške;</p> <p>3.3. dva predstavnika iz institucija koje pružaju finansijsku podršku, od kojih jedan mora da bude nadležan za budžet/finansije.</p> <p>4. Pored redovnih lanova Komisije za procenu kao iz stava 3. ovog lana, davalac finansijske podrške treba da obezbedi odlukom jednog (1) rezervnog lana, koji ce po potrebiti zameniti lana Komisije za procenu koji je u sukobu interesa.</p> <p>5. Komisija za procenu se uspostavlja tokom perioda dok je otvoren javni poziv a imena lanova komisije za procenu se javno objavljuju u roku od sedam (7) dana posle osnivanja komisije.</p> <p>6. Komisija za procenu na svom prvom sastanku donosi poslovnik o radu, kojim se rukovodi rad ove komisije i ove pravila su objavljeni u roku od sedam (7) dana nakon usvajanja.</p> <p>7. lanovi komisije za procenu ne mogu biti politiki imenovani.</p>
---	---	---

<p align="center"><b>Neni 9</b> <b>Komisioni i Ankesave</b></p>	<p align="center"><b>Article 9</b> <b>Complaints Commission</b></p>	<p align="center"><b>lan 9</b> <b>Komisija za žalbe</b></p>
<p>1. Secili ofrues i mbështetjes financiare që ka shpallur thirrje publike për mbështetje financiare themelon Komision e Ankesave, i përbërë nga anëtarët që kanë përvojë dhe integritet, i cili ka për mandat shqyrtimin e ankesave të aplikantëve.</p> <p>2. Komisioni i Ankesave ka mandat të shqyrtojë ankesat ndaj vendimeve për mos kualifikim si rezultat i mospërmbushjes së kriterëve procedurale të parapara me nenet 10 dhe 11 të kësaj Rregulloreje, si dhe ankesat ndaj vendimit për ndarje të mbështetjes financiare, në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të mbështetjes financiare.</p> <p>3. Komisioni i Ankesave përbëhet nga 3 anëtarë dhe ka mandat 2 vjeçar.</p> <p>4. Përveç anëtarëve të rregullt të Komisionit të Ankesave nga paragrafi 3 i këtij neni, ofruesi i mbështetjes financiare duhet të parasheh me vendim edhe një (1) anëtarë rezervë, i cili do të zëvendësojë në rast nevojë anëtarin e komisionit i cili ka konflikt interesi.</p> <p>5. Përbërja e komisionit caktohet me vendim të zyrtarit kryesor administrativ, përkatësisht udhëheqësit të organizatës, institucionit. Në Komisionin Ankesave nuk mund të marrin pjesë anëtarët të cilët kanë marrë pjesë në shqyrtimin e aplikacionit në kuadër të Komisionit Vlerësues dhe të emëruarit politik.</p>	<p>1. Each provider of financial support that has published a public call for financial support establishes a Complaints Commission, consisting of members who have experience and integrity, which is mandated to review of the applicants' complaints.</p> <p>2. The Complaints Commission has the mandate to examine complaints against decisions for non-qualification as a result of not fulfilling the procedural requirements foreseen in Articles 10 and 11 of this Regulation, as well as complaints against the decision on provision of financial support in the process of selection of beneficiaries for financial support.</p> <p>3. The Complaints Commission consists of 3 members and has a 2-year mandate.</p> <p>4. Besides regular members of the Complaints Commission as specified in paragraph 3 of this Article, the provider of financial support should foresee by decision also one (1) backup member, who will replace if necessary any member of the Committee who has a conflict of interest.</p> <p>5. The composition of the commission is appointed by decision of the chief administrative officer, or head of the organization, institution. Complainants Commission cannot be attended by members who participated in the review of the application as part of Evaluation Committee</p>	<p>1. Svaki davalac finansijske podrške koji je objavio javni poziv za finansijsku podršku uspostavlja Komisiju za žalbe, sastavljen od članova koji imaju iskustvo i integritet, koja ima mandat za pregled žalbi i pritužbi.</p> <p>2. Komisija za žalbe ima mandat da istražuje žalbe protiv odluka za nekvalifikovanje kao rezultat neispunjavanja procesnih uslova predviđeni u članovima 10 i 11 iz ove Uredbe, kao i žalbe protiv odluke u procesu odabira korisnika finansijske podrške.</p> <p>3. Komisija za žalbe se sastoji od 3 članova i ima rok od 2 godine.</p> <p>4. Pored redovnih članova Komisija za žalbe iz stava 3. ovog člana, davalac finansijske podrške treba da obezbedi odlukom jednog (1) rezervnog člana, koji će zameniti ako je potrebno član komisije koji je u sukobu interesa.</p> <p>5. Sastav komisije se određuje odlukom glavnog administrativnog službenika, odnosno rukovodioca organizacije/institucije. U Komisiji za žalbe ne mogu učestvovati članovi koji su učestvovali u ispitivanju predloga u okviru Komisije za procenu i politički imenovana lica.</p>

<p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI III KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË APLIKANTËT</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10 Kriteret e përgjithshme</b></p> <p>1. Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:</p> <p>1.1. të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora;</p> <p>1.2. të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-në e huaj;</p> <p>1.3. të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;</p> <p>1.4. të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete; dhe</p>	<p>and political appointees.</p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER III CRITERIA THAT APPLICANTS SHOULD MEET</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 10 General Criteria</b></p> <p>1. In order to qualify for public financial support, applicants should meet minimal general criteria determined by the following provisions:</p> <p>1.1. to be registered as an NGO, as required by the legislation on freedom to associate in non-governmental organizations in the Republic of Kosovo or in the country where the diaspora is concentrated;</p> <p>1.2. to be equipped with fiscal number according to the tax legislation of the Republic of Kosovo respectively the equivalent documentation according to the legislation of the respective country for the foreign NGO;</p> <p>1.3. have completed all previous obligations of any previous financial support, if they have benefited from public funding sources;</p> <p>1.4. have not received funds from other funding sources for the same activities; and</p>	<p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE III KRITERIJUMI KOJE PODNOSIOCI APLIKACIJA TREBA DA ISPUNE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Ian 10 Opšti kriterijumi</b></p> <p>1. Da bi se kvalifikovali za javnu finansijsku podršku, podnosioci predloga moraju da ispunjavaju minimalne opšte kriterijume uspostavljene po sledecem:</p> <p>1.1. da su registrovani kao nevladina organizacija po zahtevima zakona o slobodi udruživanja u nevladinim organizacijama na Kosovu ili u državi gde je dijaspora je koncentrisan;</p> <p>1.2. da su opremljeni fiskalnim brojem na osnovu poreskog zakonodavstva Republike Kosova ili ekvivalentni dokumentacije po zakonu doti ne države za strane NVO;</p> <p>1.3. da su završili sve prethodne obaveze finansijske podrške, ukoliko su imali koristi od javnih izvora finansiranja;</p> <p>1.4. da nisu dobili sredstva iz drugih izvora finansiranja za iste aktivnosti; i</p>
--	--	---

<p>1.5. të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.</p> <p>2. Me qëllim të dëshmimit për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, për paragrafët 1.1 dhe 1.2. të këtij neni, aplikuesi dorëzon certifikatat përkatëse; dhe për paragrafët 1.3, 1.4, dhe 1.5. aplikuesi nënshkruan dhe dorëzon deklaratat përkatëse.</p> <p>3. Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme, aplikuesi nuk mund të kualifikohet për mbështetje financiare.</p>	<p>1.5. cease to exist any conflict of interest between the applicant, respectively representatives / chief of the applicant and the budgetary organization or public institution, as required by the applicable legislation in the Republic of Kosovo.</p> <p>2. In order to prove the fulfilment of general criteria for paragraphs 1.1 and 1.2. of this article, the applicant shall submit the relevant certificates; and for paragraphs 1.3, 1.4, and 1.5 applicant should sign and submit the relevant statements.</p> <p>3. In case of failure to meet any of the general criteria, the applicant cannot qualify for financial support.</p>	<p>1.5. da ne postoji bilo kakav sukob interesa izme u podnosioca predlog projekta, odnosno predstavnika/lidera podnosioca zahteva i budžetske organizacije ili javne institucije, u skladu sa zakonima na snazi u Republici Kosovo.</p> <p>2. Sa ciljem da se dokaže ispunjenost opštih kriterijuma u stavovima 1.1 i 1.2. ovog lana, podnosilac predloga mora da podnese odgovarajuće sertifikate; i za stavove 1.3, 1.4, i 1.5. podnosilac potpisuje i podnosi odgovarajuće izjave.</p> <p>3. Ukoliko ne ispuni neki od opštih kriterijuma, podnosilac prijave ne može da se kvalifikuje za finansijsku podršku.</p>
<p>vendim përfundimtar në procedurën administrative.</p> <p>6. Vendimi duhet t'i dërgohet parashtruesit të ankesës dhe Komisionit Vlerësues.</p> <p>7. Komisioni i Ankesave mban procesverbal për gjithë procesin e trajtimit të ankesave dhe vendimmarrjes.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 22</b> <b>Kontrata me përfituesin</b></p> <p>1. Ofruesi i mbështetjes financiare lidh kontratë me shkrim me përfituesin mbështetjes financiare brenda nëntëdhjetë (90) ditësh nga dita e mbylljes thirrjes publike.</p> <p>2. Kontrata me përfituesin përmban:</p> <p>2.1. detaje lidhur me shumën e financimit, periudhën e zbatimit, monitorimin e zbatimit dhe raportimin për projektin/programin e përfituesit;</p> <p>2.2. dispozita me të cilat përcaktohet qartë se cili është qëllimi i mbështetjes financiare dhe ndalimin e përdorimit të mjeteve për qëllime tjera;</p> <p>2.3. dispozita me të cilat obligohet përfituesi që mjetet nga mbështetja financiare t'i shpenzojë përmes transaksioneve bankare në përputhje me kërkesat e legjisllacionit në fuqi;</p> <p>2.4. dispozita me të cilat tregohet mënyra</p>	<p>administrative procedure.</p> <p>6. The decision must be sent to the complainant and to the Evaluation Committee.</p> <p>7. Complaints Commission keeps records for the entire process of handling complaints and decisions-making.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 22</b> <b>Contract with beneficiary</b></p> <p>1. Provider of financial support enters into contract in written with beneficiary of financial support within ninety (90) days from the date of public call closure.</p> <p>2. Contract with beneficiary contains:</p> <p>2.1. details on the amount of the funding, implementation period, monitoring on the implementation and reporting for the beneficiary project / program;</p> <p>2.2. provisions which clearly define the purpose of financial support and banning the use of funds for other purposes;</p> <p>2.3. provisions that beneficiary is obliged to spend the financial support means through bank transactions in accordance with the requirements of applicable law;</p> <p>2.4. provisions that indicate method and</p>	<p>u upravnom postupku.</p> <p>6. Odluka mora biti poslata pdnosiocu žalbe i Komisiji za procenu.</p> <p>7. Komisija za žalbe vodi evidenciju o svim žalbama proces i odlu ivanje rukovanja.</p> <p style="text-align: center;"><b>lan 22</b> <b>Ugovor sa korisnikom</b></p> <p>1. Davalac finansijske podrške sklapa ugovor u pisanoj formi sa korisnikom finansijske podršku u roku od devedeset (90) dana od dana zatvaranja javnog poziva.</p> <p>2. Ugovor sa korisnikom sadrži:</p> <p>2.1. podatke u vezi sa iznosom sredstava, period sprovo enja, monitoring sprovo enja i izveštavanje projekta/programa korisnika;</p> <p>2.2. odredbe kojima se jasno odre uje koja je svrha finansijske podrške i zabrana korišćenja sredstava za druge namene;</p> <p>2.3. odredbe kojima se korisnik obavezuje da sredstva iz finansijske podrške potroši kroz bankarske transakcije u skladu sa zahtevima važeceg zakona;</p> <p>2.4. odredbe kojima se odre uje na in i</p>
---	--	---



<p>dhe afatet e pagesës duke përfshirë shumën në paradhënies;</p> <p>2.5. dispozita me të cilat shmangët konflikti i interesit gjatë shpenzimit të mjeteve nga mbështetja financiare;</p> <p>2.6. dispozita lidhur me rastet kur mund të shkëputet kontrata;</p> <p>2.7. dispozita me të cilat rregullohet kthimi i mjeteve në rast të shkëputjes së kontratës;</p> <p><b>KAPITULLI VI METODOLOGJIA E MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT</b></p> <p><b>Neni 23</b> <b>Monitorimi dhe raportimi projekteve dhe programeve</b></p> <p>1. Për secilën kontratë të lidhur, ofruesi i mbështetjes financiare cakton një zyrtar përgjegjës i cili duhet kujdeset për monitorimin e implementimit të projektit. Ofruesi i mbështetjes financiare mund të themelojë ekip për këtë qëllim.</p> <p>2. Përfituesi raporton te zyrtari monitorues, përkatësisht ekipi monitorues, në baza të rregullta, lidhur me zbatimin e projektit/programit, sipas kërkesave të kontratës së përcaktuar në nenin 22 të kësaj Rregulloreje. Raportimi përfshin raporte narrative dhe financiare dhe periudhat</p>	<p>timelines of payment including the amount in advance;</p> <p>2.5. provisions that avoid conflicts of interest in spending the funds from the financial support;</p> <p>2.6. provisions related to cases when contracts may be terminated;</p> <p>2.7. provisions that regulate the return of funds in case of contract termination;</p> <p><b>CHAPTER VI MONITORING AND REPORTING METHODOLOGY</b></p> <p><b>Article 23</b> <b>Monitoring and reporting of projects and programs</b></p> <p>1. For each concluded contract, the provider of financial support designates a responsible official who should take care to monitor the implementation of the project. Financial support provider may establish a team for this purpose.</p> <p>2. Beneficiary reports to the monitoring officer, or the monitoring team on a regular basis regarding the implementation of the project / program as required by the contract stipulated in Article 22 of this Regulation. The reporting includes narrative and financial reports and the reporting periods will be determined by the</p>	<p>rokove placanja obuhvataju i unapred uplaceni iznos;</p> <p>2.5. odredbe koje izbegavaju sukob interesa u trošenju sredstava iz finansijske podrške;</p> <p>2.6. odredbe koje se odnose na slu ajeve tokom kojih može da se prekine ugovor;</p> <p>2.7. odredbe koje regulišu povratak sredstava u slu aju raskida ugovora;</p> <p><b>POGLAVLJE VI METODOLOGIJA MONITORINGA I IZVEŠTAVANJA</b></p> <p><b>Ilan 23</b> <b>Monitoring/prapenje i izveštavanje o projektima i programima</b></p> <p>1. Za svaki zaklju en ugovor, davalac finansijske podrške odre uje jednog odgovornog službenika koji bi trebalo da se pobrine za monitoring/pracenje implementacije projekta. Davalac finansijske podrška može uspostaviti i celokupan tim za ovu svrhu.</p> <p>2. Korisnik izveštava službenika za monitoring, odnosno tim za monitoring na redovnoj osnovi u vezi sa sprovo enjem projekta/programa kao što je predvi eno ugovorom utvr eno u lanu 22 iz ove Uredbe. Izveštavanje uklju uje narativni i finansijski izveštaj a periodi izveštavanja bi e odre eni u</p>
---	---	--

<p>raportuese do të përcaktohen me dispozitat e kontratës me përfituesin.</p> <p>3. Në rast të evidentimit të shkelje së kontratës nga përfituesi, zyrtari/ekipi monitorues raporton te zyrtari kryesor administrativ ose udhëheqësi i institucionit, duke rekomanduar për hapat e mëtejshme. Masat e propozuara duhet të jenë proporcionale me shkeljen e bërë nga përfituesi.</p> <p>4. Në rastet e shkeljeve të rënda të kontratës, ofruesi i mbështetjes financiare mund të nxjerr vendim për anulimin e kontratës dhe masa për iniciimin e procedurave gjyqësore përkatëse.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 24</b> <b>Detyrat dhe përgjegjësitë e ofruesve të mbështetjes financiare në monitorimin dhe raportimin për projektet/programit</b></p> <p>1. Ofruesit e mbështetjes financiare kanë për detyrë që të gjithë mbështetjen financiare publike për OJQ-të ta shpërndajnë sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.</p> <p>2. Ofruesit e mbështetjes financiare kanë për detyrë të bëjnë monitorimin e rregullt dhe të drejtpërdrejtë të mbështetjes financiare publike për OJQ-të, me qëllim që ajo të jetë në linjë me kërkesat e Rregullores, dhe të arrijë qëllimin për të cilin është ofruar mbështetja financiare publike. Monitorimi duhet të sigurojë informacion mbi:</p>	<p>provisions of the contract with beneficiary.</p> <p>3. In case of evidencing violation of the contract by the beneficiary, the official / monitoring team reports to the chief administrative officer or the head of the institution, recommending for further steps. The proposed measures must be proportional with violations committed by the beneficiary.</p> <p>4. In cases of serious breaches of contract, the provider of financial support may issue a decision to cancel the contract and take measures to initiate appropriate court procedures.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 24</b> <b>Duties and responsibilities of financial support providers in monitoring and reporting for projects / program</b></p> <p>1. Providers of financial support are obliged to disseminate all public financial support for NGOs according to provisions of this Regulation.</p> <p>2. Providers of financial support are obliged to do regular and direct monitoring of public financial support for NGOs in order to be in line with the requirements of the Regulation, and achieve the purpose for which the public financial support is provided. Monitoring should provide information on:</p>	<p>skladu sa odredbama ugovora sa korisnikom.</p> <p>3. U slu aju ustanovljene povrede ugovora od strane korisnika, službenik/tim za monitoring izveštavaju glavnog administrativnog službenika ili direktora institucije i preporu uju dalje korake. Predložene mere moraju biti u srazmeri sa povredama po injenim od strane korisnika.</p> <p>4. U slu aju teškog kršenja ugovora, davalac finansijske podrške može doneti odluku da raskine ugovor i pokrene mere za odgovaraju i sudski postupak.</p> <p style="text-align: center;"><b>Ian 24</b> <b>Dužnosti i odgovornosti davaoca finansijske podrške u pra enju i izveštavanju o projektu/programu</b></p> <p>1. Davaoci finansijske podrške imaju dužnost da sve vidove javne finansijske podrške za nevladine organizacije da raspodeli u skladu sa odredbama ove Uredbe.</p> <p>2. Davaoci finansijske podrške imaju obavezu da redovno prate direktnu javnu finansijsku podršku za NVO u cilju da to bude u skladu sa zahtevima Uredbe, i posti i svrhu zbog koje se pruža javna finansijska podrška. Monitoring treba da pruži informacije o:</p>
--	---	--

<p>2.1. Rregullsinë e shpenzimit të fondeve publike;</p> <p>2.2. Realizimin e aktiviteteve të projektit dhe projektit, në tërësi;</p> <p>2.3. Rezultatet e arritura përmes implementimit të projektit; dhe</p> <p>2.4. Ndikimet e projektit.</p> <p>3. Krahas monitorimit të rregullt, përmes raporteve të dorëzuara, ofruesit e mbështetjes financiare publike bën monitorim në terren, dhe atë së paku:</p> <p>3.1. Për projektet që janë më të gjata se një vit, duhet të kryhet të paktën një vizitë në terren brenda një viti; dhe</p> <p>3.2. për projektet me kohëzgjatje më të shkurtër se një vit, duhet të bëhet të paktën një vizitë në terren gjatë zbatimit të projektit.</p> <p>4. Ofruesi i mbështetjes financiare, bazuar në të dhënat e grumbulluara gjatë monitorimit të zbatimit të projekteve dhe programeve të financuara, kryejnë vlerësimin periodik të mbështetjes së dhënë financiare.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 25</b> <b>Procesi i monitorimit dhe raportimit</b></p> <p>1. Secili ofrues i mbështetjes financiare është i</p>	<p>2.1. Regularity of public funds' expenditure;</p> <p>2.2. Implementation of project activities and the project as a whole;</p> <p>2.3. The results achieved through the implementation of the project; and</p> <p>2.4. Impacts of the project.</p> <p>3. Besides the regular monitoring, through reports submitted, providers of public financial support do on site monitoring, and at least:</p> <p>3.1. For projects that are longer than one year, it must be done at least one site visit within a year; and</p> <p>3.2. For projects with a duration of less than a year, it must be done at least one site visit during the project implementation.</p> <p>4. Provider of financial support performs periodic assessment of the financial support based on data collected during the monitoring of the implementation of projects and programs funded.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 25</b> <b>Process of monitoring and reporting</b></p> <p>1. Each provider of financial support is obliged</p>	<p>2.1. Regularnost potrošnje iz javnih fondova;</p> <p>2.2. Realizovanje aktivnosti projekta ili programa, u celosti;</p> <p>2.3. Rezultati postignuti preko implementacije projekta; i</p> <p>2.4. Uticaju projekta.</p> <p>3. Pored redovnog nadzora, putem dostavljenih izveštaja, davaoci javne finansijske podrške vrše i nadzor na terenu, i to najmanje:</p> <p>3.1. Za projekte koji su duži od godinu dana, mora se izvršiti najmanje jedna terenska poseta u toku jedne godine; i</p> <p>3.2. Za projekte koji traju manje od godinu dana, mora se izvršiti najmanje jedna terenska poseta tokom sprovo enja projekta.</p> <p>4. Davalac finansijske podrške, na osnovu podataka prikupljenih tokom nadzora sprovo enja finansiranih projekata i programa, vrši periodi nu procenu date finansijske podrške.</p> <p style="text-align: center;"><b>Ian 25</b> <b>Proces nadzora i izveštavanja</b></p> <p>1. Svaki davalac finansijske podrške je dužan</p>
--	--	--

<p>obliguar të mbledhë dhe të administrojë të dhënat për mbështetjen financiare publike në kuadër të atij institucioni gjatë gjithë kohës së zbatimit të projekteve/programeve. Për këtë qëllim raportimi nga ana e përfituesve të mbështetjes financiare është i domosdoshëm, në formatin e përcaktuar me Rregullore dhe Manual.</p>	<p>to collect and manage the data for public financial support within the institution at all times during the implementation of projects / programs. For this purpose, the reporting by the beneficiaries of financial support is obligatory in the format specified by the Regulation and the Manual.</p>	<p>da prikuplja i upravlja podacima za javnu finansijsku podršku, u okviru date institucije, tokom celog perioda trajanja sprovedenja projekata/programa. Za tu svrhu je neophodno izveštavanje od strane korisnika finansijske podrške, u formatu koji je određen Uredbom i Priručnikom.</p>
<p>2. Për projektet e financuara nga burimet publike të financimit, ofruesit e mbështetjes financiare publike përgatisin dhe bëjnë publike në ueb faqen e tyre një raport përmbledhës sa i përket projekteve/programeve të financuara nga burimet publike të financimit. Raporti, ndër të tjera, përmban listën e plotë të të gjitha projekteve/programeve të mbështetura me informacionin në vijim:</p>	<p>2. For projects financed by public sources of funding, providers of public financial support prepare and make public on their website a summary report regarding projects / programs financed by public funding sources. The report, among other things, contains a complete list of all projects / programs supported with the following information:</p>	<p>2. Za projekte koji se finansiraju iz javnih izvora finansija, pružaoci javne finansijske podrške pripremaju i objavljuju na njihovom veb-sajtu jedan zbirni izveštaj vezan za projekte/programe koji se finansiraju iz javnih izvora finansija. Izveštaj, izmeđ u ostalog, sadrži kompletnu listu svih projekata/programa koji su podržani, i sledeće informacije:</p>
<p>2.1. Emrin e ofruesit të mbështetjes financiare publike, duke përfshirë programet specifike në kuadër të të cilave ofrohet mbështetja financiare publike;</p>	<p>2.1. Name of provider of the public financial support, including specific programs with which the public financial support is given;</p>	<p>2.1. Ime pružaoca javne finansijske podrške, ukljuuju i specifične programe u okviru kojih se pruža javna finansijska podrška;</p>
<p>2.2. Mënyrën e alokimit të mbështetjes financiare publike;</p>	<p>2.2. Method of allocation of public financial support;</p>	<p>2.2. Način raspodele javne finansijske podrške;</p>
<p>2.3. Thirrjen publike përmes të cilës është ofruar mbështetja financiare;</p>	<p>2.3. Public call through which the financial support is provided;</p>	<p>2.3. Javni poziv putem kojeg se nudi finansijska podrška;</p>
<p>2.4. Emrin e plotë të përfituesve të mbështetjes financiare, duke përfshirë të dhënat tjera të përfituesit, adresën, numrin e regjistrimit, numrin fiskal dhe të dhënat për personin përgjegjës të OJQ-së;</p>	<p>2.4. Full name of the beneficiaries of financial support, including other beneficiary data, address, registration number, fiscal number and information related to the person responsible for the NGO;</p>	<p>2.4. Puno ime korisnika finansijske podrške, ukljuuju i druge podatke za korisnike, adresu, matični broj, poreski broj i informacije u vezi osobe koja je odgovorna za NVO;</p>
<p>2.5. Emërtimin e projektit/programit apo</p>	<p>2.5. Name of the project / program or</p>	<p>2.5. Naziv finansiranog projekta/programa,</p>

<p>aktiviteteve të financuara;</p> <p>2.6. Shumën e dhënë për financimin e projektit/programit;</p> <p>2.7. Kohëzgjatjen e projektit dhe statusin e zbatimit të tij;</p> <p>2.8. Fushat e përgjithshme dhe specifike të financimit;</p> <p>2.9. Përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë;</p> <p>2.10. Aktivitetet kryesore të realizuara në kuadër të projektit;</p> <p>2.11. Të dhënat gjeografike sa i përket vendit të implementimit të projektit;</p> <p>2.12. Numrin e përafërt të personave që kanë përfituar apo janë punësuar në kuadër të projekti/programit.</p> <p>3. Raportimi sipas këtij neni bëhet sipas formularit përkatës, i cili duhet të plotësohet nga secili ofrues i mbështetjes financiare publike.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 26</b> <b>Përgatitja e raportit gjithëpërfshirës vjetor të mbështetjes financiare publike për OJQ-të</b></p> <p>1. Secili ofrues i mbështetjes financiare publike pasi të përgatis raportin vjetor sipas nenit 25 të kësaj Rregulloreje, do t'i dërgojnë</p>	<p>activity funded;</p> <p>2.6. The amount given for funding the project / program;</p> <p>2.7. Duration of the project and status of its implementation;</p> <p>2.8. General and specific areas of financing;</p> <p>2.9. Direct and indirect beneficiaries;</p> <p>2.10. Main activities carried out within the project;</p> <p>2.11. Geographical data concerning the place of project implementation;</p> <p>2.12. Approximate number of persons who have benefited or are employed within the project / program.</p> <p>3. Reporting under this Article is done according to the form, which should be completed by each provider of public financial support.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 26</b> <b>Preparing a comprehensive annual report of public financial support for NGOs</b></p> <p>1. Each provider of public financial support, upon the preparation of annual report according to Article 25 of this Regulation will send an</p>	<p>ili aktivnosti;</p> <p>2.6. Iznos sredstava za projekat/program;</p> <p>2.7. Trajanje projekta i status njegovog sprovo enja;</p> <p>2.8. Opšte i posebne oblasti finansiranja;</p> <p>2.9. Direktni i indirektni korisnici;</p> <p>2.10. Glavne aktivnosti koje su sprovedene u okviru projekta;</p> <p>2.11. Geografski podaci vezani za mesto realizacije projekta;</p> <p>2.12. Približan broj ljudi koji su imali korist, ili su zaposleni u okviru projekta/programa.</p> <p>3. Izveštavanje u skladu sa ovim lanom se vrši u odre enom formularu, koji se mora pripremiti od strane svakog davaoca javne finansijske podrške.</p> <p style="text-align: center;"><b>lan 26</b> <b>Priprema sveobuhvatnog godišnjeg izveštaja javne finansijske podrške za NVO</b></p> <p>1. Svaki davalac javne finansijske podrške, nakon što pripremi godišnji izveštaj prema lanu 25 iz ove Uredbe, dostavlja jednu</p>
---	---	--

<p>një kopje elektronike të raportit Zyrës së Kryeministrit, përkatësisht zyrës përkatëse për qeverisë të mirë, më së largu deri më 1 mars.</p> <p>2. Zyra e Kryeministrit, mbi bazën e raporteve të pranuar nga secili ofrues i mbështetjes financiare publike përgatit raportin e përgjithshëm vjetor të mbështetjes financiare publike për OJQ-të në Republikën e Kosovës më së largu deri më 31 mars të cilit vit.</p> <p>3. Për qëllimet e monitorimit dhe raportimit vjetor të mbështetjes financiare publike nga ana e ofruesve të mbështetjes financiare publike, Zyra e Kryeministrit zhvillon dhe të administron bazën e të dhënave qendrore për financimin publik të OJQ-ve, e cila do të mundësojë sigurimin e transparencës dhe qasjes së publikut në të dhënat e që kanë të bëjnë me financimin publik të OJQ-ve.</p> <p>4. Mbi bazën e kërkesës së Zyrës së Kryeministrit secili ofrues i mbështetjes financiare publike siguron informacion përkitazi me zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara me rregulloren e më sipërme, duke përfshirë edhe plotësimin e pyetësorëve të dërguar nga Zyra e Kryeministrit.</p> <p>5. Ofruesit e mbështetjes financiare publike dhe Zyra e Kryeministrit mund përdorin edhe platformat elektronike për monitorim dhe raportim nëse ato janë të aplikueshme.</p>	<p>electronic copy of the report to the Prime Minister's Office, namely the respective office for good government, no later than 1st March.</p> <p>2. Office of the Prime Minister, on the basis of reports received from each provider of public financial support, prepares a general annual report of public financial support for NGOs in the Republic of Kosovo at the latest by 31st March.</p> <p>3. For the purposes of monitoring and annual reporting of financial support by providers of public financial support, the Prime Minister's Office develops and administers the central database for public funding of NGOs, which will enable transparency and accessibility of public in the data regarding the public funding of NGOs.</p> <p>4. On the basis of request from Prime Minister's Office, each provider of public financial support provides information regarding the implementation of the criteria and procedures set forth by the above-mentioned regulation, including the completion of questionnaires sent by the Office of the Prime Minister.</p> <p>5. Providers of public financial support and the Prime Minister's Office may also use electronic platforms for monitoring and reporting if they are applicable.</p>	<p>elektronsku kopiju izveštaja Kancelariji Premijera, odnosno odgovaraju i kancelarija za dobru upravljanje najkasnije do 1. Marta date godine.</p> <p>2. Kancelarija Premijera, na osnovu izveštaja dobijenih od svakog davaoca javne finansijske podrške, priprema opšti godišnji izveštaj o javnoj finansijskoj podršci za NVO u Republici Kosovo, najkasnije do 31. Marta tekuce godine.</p> <p>3. Za potrebe nadzora i godišnjeg izveštavanja javne finansijske podrške od strane davaoca javne finansijske podrške, Kancelarija Premijera priprema i upravlja centralnom bazom podataka za javno finansiranje NVO-a, koja ce omoguciti obezbe ivanje transparentnosti i pristup javnosti svim podacima koji su vezani za javno finansiranje NVO-a.</p> <p>4. Na zahtev Kancelarije Premijera, svaki pružalac javne finansijske podrške dostavlja podatke vezane za sprovo enje kriterijuma i procedura koje su utvr ene gore-navedenom Uredbom, uklju uju i i odgovore na upitnike koje šalje Kancelarija Premijera.</p> <p>5. Pružaoci javne finansijske podrške i Kancelarija Premijera mogu koristiti i elektronske platforme za nadzor i izveštavanje, ako su one primenljive.</p>
---	---	---

<p align="center"><b>Neni 27</b> <b>Përmbajtja e raportit gjithëpërfshirës vjetor të mbështetjes financiare publike për OJQ-të</b></p>	<p align="center"><b>Article 27</b> <b>Content of comprehensive annual report of public financial support for NGOs</b></p>	<p align="center"><b>lan 27</b> <b>Sadržaj godišnjeg sveobuhvatnog izveštaja javne finansijske podrške za NVO</b></p>
<p>1. Raporti vjetor i mbështetjes financiare publike për OJQ-të përmban këto informacione:</p> <p>1.1. Pjesën hyrës;</p> <p>1.2. Një përmbledhje;</p> <p>1.3. Një analizë përmbledhëse lidhur me zbatimin e kritereve dhe procedurave të parapara me këtë Rregullore;</p> <p>1.4. Shumën e përgjithshme të mbështetjes financiare publike për vitin paraprak, si dhe të ndarë për secilin nga ofruesit e mbështetjes financiare;</p> <p>1.5. Informacion mbi fushat e përgjithshme dhe të veçanta të financimit;</p> <p>1.6. Shtrirjen territoriale të projekteve/programeve të mbështetura;</p> <p>1.7. Informacion të përpunuar lidhur me përfituesit e drejtpërdrejtë apo target grupet e synuara përmes ofrimit të mbështetjes financiare publike;</p> <p>1.8. Informacion të përpunuar lidhur me rezultatet e projekteve/programeve në fushat proritare të synuara përmes ofrimit të mbështetjes financiare publike;</p>	<p>1. The annual report of public financial support for NGOs contains the following information:</p> <p>1.1. Introduction;</p> <p>1.2. A summary;</p> <p>1.3. A comprehensive analysis regarding the implementation of the criteria and procedures foreseen by this Regulation;</p> <p>1.4. The total amount of public financial support for the previous year, and separately for each provider of financial support;</p> <p>1.5. Information about the general and particular areas of funding;</p> <p>1.6. Territorial extent of projects / programs supported;</p> <p>1.7. Elaborated information regarding the direct beneficiaries or target groups through providing a targeted public financial support;</p> <p>1.8. Elaborated information regarding the results of projects / programs targeted to priority areas through providing public financial support;</p>	<p>1. Godišnji izveštaj javne finansijske podrške za NVO sadrži sledece informacije:</p> <p>1.1. Uvodni deo;</p> <p>1.2. Sažetak;</p> <p>1.3. Sveobuhvatna analiza o primeni kriterijuma i procedura propisanih ovom Uredbom;</p> <p>1.4. Ukupan iznos javne finansijske podrške za prethodnu godinu, kao i posebno za svaki od pružaoca finansijske podrške;</p> <p>1.5. Informacije o opštim i posebnim oblastima finansiranja;</p> <p>1.6. Teritorijalnu raspodelu podržanih projekata/programa;</p> <p>1.7. Elaborat informacija o direktnim korisnicima ili ciljnim grupama za javnu finansijsku podršku;</p> <p>1.8. Elaborat informacija u vezi sa rezultatima projekata/programa u ciljane prioritetne oblasti putem pružanja javne finansijske podrške;</p>

<p>1.9. Rekomandimet, përkitazi me mbështetjen financiare publike për OJQ-të gjatë periudhës së ardhshme;</p> <p>1.10. Lisat e të gjitha projekteve/programeve të financuara nga ofruesit e mbështetjes financiare publike;</p> <p>2. Raporti vjetor do të dërgohet për miratim në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe publikohet brenda shtatë (7) ditës pas miratimit të tij.</p> <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI VII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 28 Manuali për zbatimin e Rregullores</b></p> <p>Manuali i bashkëngjitur në këtë Rregullore dhe formularët përkatës janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje dhe shfrytëzohen për zbatimin e saj.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 29 Zbatimi</b></p> <p>Përveç dispozitave të kësaj Rregulloreje që kanë të bëjnë me krijimin e kodeve të veçanta buxhetore për mbështetjen financiare publike për OJQ-të dhe për përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare publike, të cilat do të zbatohen në ciklin ardhshëm buxhetor pas hyrjes në fuqi të rregullores, të gjitha</p>	<p>1.9. Recommendations regarding public financial support for NGOs for the forthcoming period;</p> <p>1.10. Lists of all projects / programs funded by providers of public financial support;</p> <p>2. The annual report will be sent for approval to the Government of the Republic of Kosovo and it is published within seven (7) days after the approval.</p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER VII TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 28 Manual for Implementing the Regulation</b></p> <p>Manual enclosed in this regulation and relevant forms are an integral part of this Regulation and are used for its implementation.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 29 Implementation</b></p> <p>Besides the provisions of this Regulation concerning the establishment of special budget codes to support public funding for NGOs and for the preparation of annual plan for public financial support, which will be implemented in the next budget cycle after the entry into force of this Regulation, all other provisions of the</p>	<p>1.9. Preporuke vezane za javnu finansijsku podršku NVO-a u narednom periodu;</p> <p>1.10. Liste svih projekata/programa koji su finansirani od strane davaoca javne finansijske podrške;</p> <p>2. Godišnji izveštaj ce biti poslat na usvajanje Vladi Republike Kosova i objavljen u roku od sedam (7) dana nakon usvajanja.</p> <p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE VII PRELAZNE I ZAKLJU NE ODREDBE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Ian 28 Priru nik za sprovo enje Uredbe</b></p> <p>Priru nik pridodat ovoj Uredbi i relevantni formulari ine sastavni deo ove Uredbe i koristi se za njegovo sprovo enje.</p> <p style="text-align: center;"><b>Ian 29 Sprovo enje</b></p> <p>Pored odredbi ove Uredbe koja se bavi uspostavljanjem posebnih budžetskih kodova za podršku javnih finansija za nevladine organizacije i za pripremu godišnjeg plana javne finansijske podrške, koji ce biti realizovane u narednom budžetskom ciklusu nakon stupanja na snagu Uredbe, sve ostale</p>
--	--	--



<p>dispozitat tjera të Rregullores do të fillojnë të zbatohen që nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 30</b> <b>Dispozitat shfuqizuese</b></p> <p>Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen të gjitha dispozitat e akteve nënligjore në fuqi të cilat rregullojnë financimin publik të OJQ-ve nga organizatat buxhetore.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 31</b> <b>Hyrja në fuqi</b></p> <p>Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit të saj.</p> <p style="text-align: right;">_____ Ministri i Financave Avdullah Hoti</p> <p style="text-align: right;">Datë 13/06/2017</p>	<p>Regulation will begin to apply from the date of entry into force of this Regulation.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 30</b> <b>Abrogating provisions</b></p> <p>Upon the entry into force of this Regulation, it supersedes all provisions of the applicable bylaws that regulate public funding the NGOs from budgetary organizations.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 31</b> <b>Entry into force</b></p> <p>This Regulation shall enter into force seven (7) days after its publication.</p> <p style="text-align: right;">_____ Minister of Finance Avdullah Hoti</p> <p style="text-align: right;">Date 13/06/2017</p>	<p>odredbe Uredbe ce po eti da se primenjuju od dana stupanja na snagu ove Uredbe.</p> <p style="text-align: center;"><b>Ian 30</b> <b>Odredbe ukidanja</b></p> <p>Stupanjem na snagu ove Uredbe, prestaju da važe sve odredbe važećih podzakonskih akata koji regulišu javno finansiranje nevladinih organizacija iz budžetskih organizacija.</p> <p style="text-align: center;"><b>Ian 31</b> <b>Stupanje na snagu</b></p> <p>Ova Uredba stupa na snagu sedam (7) dana od njenog objavljivanja.</p> <p style="text-align: right;">_____ Ministar Finansija Avdullah Hoti</p> <p style="text-align: right;">Daum 13/06/2017</p>
---	---	--

**MANUAL**  
**PËR IMPLEMENTIMIN E RREGULLORES MF-NR**  
**04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE**  
**PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE**

## Përmbajtja

HYRJE .....	3
1. PLANIFIKIMI I MBËSHTETJES FINANCIARE DHE KAPACITETET E INSTITUCIONEVE PUBLIKE.....	3
1.1 Planifikimi i mbështetjes financiare .....	3
1.1.1 Përcaktimi i nevojave prioritare për financim .....	4
1.1.2 Përfshirjen e prioriteteve të financimit në kuadër të buxhetit vjetor të institucionit .....	5
1.1.3 Përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare publike për OJQ-të;.....	6
1.1.4 Planifikimin e implementimit të thirrjes publike;.....	6
1.2 Përgatitjen e dokumentacionit të thirrjes publike: .....	7
1.3 Përcaktimin e numrit të projekteve dhe programeve që do të financohen dhe shumave të financimit ....	7
1.4 Kapacitetet institucionale të ofruesit të mbështetjes financiare publike .....	7
2. KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË APLIKANTËT .....	8
2.1 Kriteret e përgjithshme për të marrë pjesë në kuadër të thirrjes publike me projekt propozime .....	8
3. KRITERET DHE PROCEDURAT E THIRRJES PUBLIKE DHE APLIKIMIT .....	9
3.1 Shpallja publike e thirrjes .....	9
3.2 Dokumentet e thirrjes publike.....	10
3.3 Udhëzimet e thirrjes.....	11
3.4 Formularët e aplikimit .....	12
3.4.1 Forma e përshkrimit të projektit/programit .....	12
3.4.1 Forma e përshkrimit të buxhetit të projektit.....	13
4. KRITERET DHE PROCEDURA E VLERËSIMIT TË APLIKACIONEVE.....	13
5. METODOLOGJIA E MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT .....	14
6. ANEKSET .....	15

## **HYRJE**

Manuali për implementimin e Rregullores MF-NR 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve është hartuar si një udhëzues i cili do tu mundësojë të gjitha institucionet publike të cilat ofrojnë mbështetje financiare dhe jo-financiare publike për projektet dhe programet e organizatave Jo-Qeveritare që të zbatojnë në mënyrë më të lehtë kriteret dhe procedurat e parapara me këtë rregullore. Manuali u dedikohet të gjitha institucioneve publike të nivelit qendror dhe lokal, kompanive publike, fondeve të pavarura dhe çdo institucioni tjetër i cili ofron mbështetje financiare publike për projektet dhe programet e OJQ-ve në Republikën e Kosovës.

Në përpilimin e këtij manuali janë marrë për bazë praktikatat e mira rajonale dhe ndërkombëtare që mundësojnë zbatimin me transparencë të thirrjeve publike për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve përmes fondeve publike. Struktura e manualit është në linjë dhe ndjek strukturën e Rregullores MF-NR 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve duke u përpjekur për të siguruar edhe shembuj dhe sqarime praktike për zbatimin e dispozitave të rregullores. Njëra ndër pjesët kryesore të këtij manuali janë formularët të cilët do të mundësojnë një zbatim shumë më të lehtë të dispozitave të rregullores. Këto formularë mundësojnë që secila fazë e thirrjes publike të implementohet në linjë me kërkesat e rregullores, dhe legjislacioni në fuqi në Republikën e Kosovës duke siguruar një zbatim uniform për të gjithë mbështetjen financiare publike për OJQ-të në Republikën e Kosovës. Duke marrë parasysh që deri më tani nuk ka ekzistuar një rregullativë dhe praktikë uniforme sa i përket kriterëve dhe procedurave të mbështetjes financiare publike për projektet dhe programet e OJQ-ve në Republikën e Kosovës,

## **1. PLANIFIKIMI I MBËSHTETJES FINANCIARE DHE KAPACITETET E INSTITUCIONEVE PUBLIKE**

### **1.1 Planifikimi i mbështetjes financiare**

Planifikimi i mbështetjes financiare publike për projektet dhe programet e Organizatave Jo-Qeveritare përbënë njëri nga fazat kryesore në ciklin e implementimit të mbështetjes financiare publike për OJQ-të. Në këtë drejtim duhet adresuar një numër i konsiderueshëm i çështjeve duke përfshirë:

1. Përcaktimin e nevojave me prioritet për financim;
2. Përfshirjen e prioriteteve të financimit në kuadër të buxhetit vjetor të institucionit;
3. Përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare publike për OJQ-të;

4. Planifikimin e implementimit të thirrjes publike, duke përfshirë përgatitjen dokumentacionit të thirrjes publike;
5. Përcaktimin e numrit të projekteve dhe programeve që do të financohen dhe shumave të financimit;

#### 1.1.1 Përcaktimi i nevojave prioritare për financim

Secili ofrues i mbështetjes financiare publike duhet të ketë në konsideratë faktin që mbështetja financiare publike për projektet dhe programet e Organizatave jo Qeveritare ka për qëllim që të kontribuojë në arritjen e ndonjë objekti në një fushë të veçantë, e cila është në të mirë të publikut dhe e cila është fushë me prioritet. Prandaj, përcaktimi i prioriteteve të financimit për projektet dhe programet e OJQ-ve si në nivel të institucionit që planifikon mbështetjen financiare, po ashtu edhe në nivel të përgjithshëm në Republikën e Kosovës, duhet të bëhet mbi bazën e vlerësimit të situatës aktuale, në një fushë e veçantë dhe me prioritet, në të cilën është projektuar që të adresohen nevojat e qytetarit apo komunitetit të cilin ato e synojnë.

Ofruesit e mbështetjes financiare publike duhet të identifikojnë prioritetet e financimit në bazë të objektivave dhe prioriteteve të identifikuara në planet dhe strategjitë intitucionale, sektoriale apo nacionale apo dokumentet tjera startegjike që ndërlidhen me fushën e përgjegjësisë së tyre. Këto prioritete të identifikuara për financim duhet të adresojnë nevojat e qytetarit dhe komunitetit, përfshirë nevojat mjedisore, sociale, ekonomike etj. Vlerësimi i nevojave duhet po ashtu, të mundësojë një qasje sistematike ndaj zgjidhjes së problemit që synohet të adresohet. Vlerësimi i nevojave prioritare për financim duhet të kalojë nëpër këto faza:

- ✓ Identifikimi dhe përshkrimi i situatës aktuale;
- ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave;
- ✓ Vendosja e prioriteteve

Në Republikën e Kosovës ekzistojnë akte nënligjore dhe udhëzues përkatës të cilët përcaktojnë metodologjinë dhe procedurat e përcaktimit të prioriteteve, duke përfshirë edhe metodologjinë e identifikimit të problemeve, mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave dhe vendosjes së prioriteteve në procesin e hartimit të politikave. Këto dokumente duhet të përdoren edhe në procesin e përcaktimit të nevojave prioritare për financim të projekteve dhe programeve të Organizatave Jo – Qeveritare.

Legjislacioni në Fuqi në Republikën e Kosovës kërkon nga të gjitha institucionet publike që në procesin e vendimmarrjes të ketë [konsultim ndërinstiucional dhe publik](#). Edhe përcaktimi i prioriteteve të financimit publik për projektet dhe programet e OJQ-ve duhet të jetë një proces transparent dhe të ketë një komunikim sa më të madh me qytetarët dhe publikun e në veçanti me Organizatat Jo-Qeveritare qoftë në nivel lokal apo qendror.

### **1.1.2 Përfshirjen e prioriteteve të financimit në kuadër të buxhetit vjetor të institucionit**

Rregullorja MF-NR 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në nenin 5 ka përcaktuar që secili ofrues i mbështetjes financiare duhet të përfshijë mbështetjen e tillë financiare në kuadër të linjave të veçanta buxhetore. Kjo nënkupton që shuma e mbështetjes financiare publike për projektet dhe programet e OJQ-ve duhet të planifikohet në procesin e përgatitjes së buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës, ose buxhetit të ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike për rastet kur ato institucione nuk janë organizata buxhetore (p.sh. ndërmarrjet publike, fondet e pavarura apo institucionet e ngjashme).

Si rrjedhojë, Secili ofrues i mbështetjes financiare Publike, duhet të kërkojë nga Ministria e Financave që të krijoj kode të veçanta buxhetore në rastet kur planifikohet mbështetje financiare publike për OJQ-të për vitin e ardhshëm fiskal. Fakti se institucioni përkatës (Ministria x ose komuna x) e konsideron një fushë përkatëse për mbështetje të projekteve dhe programeve të OJQ-ve si prioritare për financim, nuk do të thotë se domosdo e njëjta fushë do të financohet. Kjo për faktin se në procesin e përgatitjes së buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës numri i kërkesave për financim është shumë më i madh se sa mundësitë për financim. Prandaj, kërkesat e të gjitha institucioneve janë kërkesa konkurruese, që do të thotë se në procesin e përcaktimit të prioriteteve për financim në vitin e ardhshëm fiskal prioritetet përcaktohen edhe në nivel të Republikës së Kosovës përveç atij institucional. Është shumë e rëndësishme që nevojat prioritare të identifikuar nga ofruesit e mbështetjes financiare publike të jenë konkurrencte dhe të financohen ato të cilat me të vërtet kanë prioritet.

Çështjet përkitazi me procesin e përgatitjes së buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe afatet e propozimeve të buxheteve institucionale janë përcaktuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me legjislacionin sekondar të Ministrisë së Financave si dhe me qarkoret që lëshon në baza të rregullta Ministria e Financave.

Rregullorja ka përcaktuar që në rast se mbështetja financiare publike për OJQ-të nuk është e përfshirë në kuadër të buxhetit, si dhe nuk është e identifikuar në mënyrë specifike se është mbështetje për projektet dhe programet e OJQ-ve, institucioni nuk ka të drejtë të ofrojë mbështetje financiare për OJQ-të. Prandaj, është e domosdoshme që të ekzistojnë linja të veçanta buxhetore, të identifikuar qartë që tregojnë se shuma e ndarjes buxhetore i dedikohet mbështetjes financiare publike për projektet dhe programet e OJQ-ve. Krijimi i linjave të veçanta buxhetore në të cilat identifikohet mbështetja financiare publike për OJQ-të përveç që do të ndihmojë në rritjen e transparencës sa i përket fondeve të alokuara për shoqërinë civile, do të mundësoj edhe një menaxhim më të lehtë të mbështetjes financiare publike për OJQ-të.

### **1.1.3 Përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare publike për OJQ-të;**

Plani vjetor i mbështetjes financiare për OJQ-të është një dokument planifikues, i cili përmban të dhëna të sakta për të gjithë mbështetjen financiare publike në Republikën e Kosovës në kuadër të vitit fiskal. Duke pas parasysh që ky plan duhet të përgatitet pas Miratimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës, përgatitja e tij është shumë e lehtë pasi të dhënat që duhet të përfshihen në plan duhet të korrespondojnë me Buxhetin e Miratuar. Përgatitje e këtij plani do tu mundësoj institucioneve që me kohë të parashikojnë të gjithë hapat që do të ndjekin në ofrimin e mbështetjes financiare publike, dhe me këtë rast të ndërmarrin të gjitha veprimet për ta implementuar thirrjen publike me sukses. Po ashtu do tu mundësoj OJQ-ve që të përgatiten për thirrjet publike.

Në Formularin F1 të këtij manuali është paraqitur forma për përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare publike. Të njëjtin formular duhet ta plotësoj secili institucion i cili ka paraparë që gjatë vitit të ardhshëm fiskal të ofrojë mbështetje financiare për projektet dhe programet e OJQ-ve. Duke pas parasysh që datat e miratimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin e ardhshëm fiskal nuk janë të ditura, secili ofrues i mbështetjes financiare duhet jo më larg se 30 ditë nga miratimi i buxhetit të Republikës së Kosovës të plotësoj formularin e planit vjetor të mbështetjes financiare dhe ti dërgojnë ZKM-ZQM-së. Të dhëna shtesë sa i përket plotësimin të formularit janë përfshirë në vetë formularin (shtojcën 1).

ZKM-ZQM do të bashkëpunim me organizatat buxhetore, Ministrinë e Financave dhe institucionet tjera publike do të përgatis planin përmbledhës vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të, i cili do të përfshijë të gjitha planet vjetore të organizatat buxhetore dhe institucionet tjera publike. Edhe plani gjithëpërfshirës do të përgatitet sipas të njëjtit formular. Zyra për Qeverisje të Mirë, mund të komunikoj me institucionet tjera dhe tu jap sqarimet e nevojshme për plotësimin e formularit gjatë përgatitjes së planit vjetor.

[Publikimi i planit vjetor të mbështetjes financiare](#) - Ofruesi i mbështetjes financiare duhet që planin vjetor të mbështetjes financiare publike për OJQ-të ta publikoj menjëherë në ueb faqen e vet. Publikimi ka për qëllim që të mundësoj rritjen e transparencës në ofrimin e mbështetjes financiare publike për OJQ-të, duke u mundësuar OJQ-ve të interesuar që paraprakisht të përgatitjen për thirrjen publike. Plani i përgjithshëm i mbështetjes financiare publike për OJQ-të duhet të publikohet në ueb faqen e Zyrës së Kryeministrit.

### **1.1.4 Planifikimin e implementimit të thirrjes publike;**

Sipas rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve në mënyrë të shprehur ka paraparë që mbështetja financiare publike për OJQ-të mund të bëhet vetëm përmes një thirrje publike. Në këtë kontekst që në fillim të vitit ofruesit e mbështetjes financiare publike duhet të planifikojnë një kalendar kohor brenda të cilit ata do të implementojnë thirrjen publike. Miratimi i Planit vjetor të mbështetjes financiare publike duhet të shërbej si kalendar tentativ për implementimin e thirrjes

publike. Në këtë kontekst, institucioni duhet të planifikoj edhe shfrytëzimin e resurseve njerëzore për përgatitjen e thirrjes publike, pjesëmarrje në komisionet vlerësuese dhe punë të ngjashme rreth thirrjes publike.

## **1.2 Përgatitjen e dokumentacionit të thirrjes publike:**

Ndonëse, Manuali për implemtimin e rregullorës përmban shumicën e formave të cilat lehtësisht mund të përshtaten për secilën thirrje publike, prapë se parap secili nga institucionet të cilat planifikojnë mbështetje financiare publike duhet të bëjë përshtatjen e dokumentacionit në përputhje me kërkesat e thirrjes publike. Prandaj, departamenti përkatës në kuadër të institucionit ose ekipi i caktuar me vendim të udhëheqësit të institucionit duhet të bëjë përshtatjen e thirrjes publike dhe formave përkatëse për qëllimet e thirrjes publike. Udhëheqësi i institucionit përkatës mund të nxjerr vendim me të cilin i cakton ekip që do të merret me përgatitjen e dokumentacionit për shpalljen e thirrjes publike.

## **1.3 Përcaktimin e numrit të projekteve dhe programeve që do të financohen dhe shumave të financimit**

Me rastin e përcaktimit të numrit të projekteve dhe programeve që do të financohen ofruesi i mbështetjes financiare publike duhet të marr parasysh shumën në dispozicion të fondeve të miratuara në kuadër të buxhetit për vitin konkret e që janë të dedikuara për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve. Po ashtu, duhet të marrë parasysh edhe kapacitetet institucionale për të monitoruar zbatimin e projekteve. Me rastin e përcaktimit të numrit të projekteve që do të financohen, duhet të merren parasysh si në vijim:

- Shuma totale e fondeve në dispozicion;
- Shumat e parashikuara për fushat e thirrjes nëse thirrja është shpallur për një numër fushash;
- Shuma minimale dhe shumata maksimale e kontratave individuale për mbështetje;

Mbi bazën e këtyre vlerësimeve, ofruesi i mbështetjes financiare duhet të caktoj numrin e përafërt të përfituesve nga mbështetja financiare publike për OJQ-të.

## **1.4 Kapacitetet institucionale të ofruesit të mbështetjes financiare publike**

Implementimi i thirrjes publike kërkon edhe angazhimin e personelit në përgatitjen e thirrjes publike, si dhe në vlerësimin e aplikimeve dhe përzgjedhjen e përfituesve. Prveç kësaj, kërkohet një monitorim i vazhdueshëm i projekteve të financuara. Në këtë drejtim, rregullorja për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të ka përcaktuar që institucionet të plotësojnë disa kërkesa minimale të kapaciteteve njerëzore dhe profesionale në mënyrë që të mund të ofrojnë mbështetje financiare publike për OJQ-të. Me vendimin për hapjen e thirrjes publike, institucioni do të përcaktoj



edhe trupat përgjegjës për implementimin e thirrjes, dhe po ashtu do të vendos edhe për emrimin e komisionit vlerësues, i cili do të jetë përgjegjës për administrimin e të gjithë procesit të aplikimeve dhe vendosjes për përzgjedhjen e pjesëmarrësve. Prandaj, institucionet duhet të kenë parasysh burimet njerëzore që i kanë në dispozicion për implementimin e thirrjes publike me rastin e marrjes së vendimit për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve. Formularët përkatës për punën e komisionit, deklaratave të pashmërisë, dhe konfidencialitetit, si dhe shmangies së konfliktit të interesit janë pjesë përbërëse e këtij manuali Formulari F7.

## **2. KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË APLIKANTËT**

### **2.1 Kriteret e përgjithshme për të marrë pjesë në kuadër të thirrjes publike me projekt propozime**

Dispozitat e rregullores kanë paraparë një numër të kushteve të përgjithshme të cilat duhet ti plotësoj secila OJQ aplikuese. Përmes vendosje së këtyre kushteve të përgjithshme aplikohen standardet minimale formale të cilat, kërkohen nga Organizatat JO-Qeveritare të cilat synojnë implementimin e projekteve ose programeve përmes mbështetjes financiare publike.

Neni 10 dhe 11 i rregullores për kriteret dhe procedurat e mbështetjes financiare publike për OJQ-të ka paraparë këto kritere formale:

- OJQ-të aplikuese të jenë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike - (për të dëshmuar këtë kërkesë, OJQ-ja aplikuese duhet të dërgoj kopjen e certifikatës së regjistrimit me rastin e aplikimit;
- Të jetë e pajisur me Numër Fiskal – të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës. Me rastin e aplikimit OJQ- duhet të dëshmojë këtë kërkesë përmes kopjes së certifikatës së numrit fiskal.
- OJQ-të aplikuese duhet të kenë kryer të gjitha detyrimet tatimore ndaj ATK-së. Ndonëse mund të ketë detyrime të pashlyera në momentin e aplikimit, OJQ-ja që përfiton nga fondet publike para nënshkrimit të kontratës duhet të dëshmojë se ose ka kryer obligimet tatimore ose ka arritur ndonjë marrëveshje me ATK-në për kryerjen e tyre në të ardhmen. Ekzistenca e borxheve dhe obligimeve tjera të pashlyera nuk guxon të ndikoj në implementimin e projektit, prandaj, zgjidhja e çfarëdo detyrimi të tillë para nënshkrimit të kontratës është e domosdoshme.
- OJQ-ja aplikuese nuk duhet të ketë pranuar mjete financiare për realizimin e të njëjtave aktivitete në vitin përkatës fiskal. Prandaj, me rastin e aplikimit kërkohet një deklaratë e cila e shmangë financimin e dyfishtë për aktivitetet e njëjta.
- Të kenë dorëzuar një projekt propozim sipas formularit e aplikacionit të projektit/programit Formulari F9 së bashku me formularin e propozim buxhetit sipas formularit F10.

Komisioni Vlerësues i Ofruesit të mbështetjes financiare varësisht nga kushtet dhe kërkesat e thirrjes publike përmbushjen e kritereve formale do të bëjë një vlerësim formal të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikuesit. Përmbushja e kritereve formale nënkupton dorëzimin brenda fatait të thirrjes të një aplikimi me projektpropozim, së bashku me dokumentet e kërkuara përmes thirrjes. Disa nga

dokumentet kryesore të cilat Ofruesi i mbështetjes financiare varësisht nga thirrja publike do të kërkojë të dorëzohen nga OJQ-të përfshijnë:

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së (Obligative)
2. Certifikatën e numrit fiskal (obligative)
Në Kosovë ekzistojnë një numër i madh i organizatave Jo Qeveritare të cilat merren me promovimin dhe mbrojtjen e fëmijës dhe të drejtave të tyre, disa prej të cilave kanë një përvojë të konsiderueshme dhe shumë të nevojshme për avancimin e të drejtave të fëmijëve. Prandaj, duke pas parasysh rolin dhe përvojën që kanë Organizatat Jo-qeveritare në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në Kosovë, bashkëpunimi me OJQ-të në arritjen e prioriteteve në këtë fushë është tejet i rëndësishëm për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Strategjinë për Bashkëpunim me shoqërinë civile, e cila objektivat e saja kryesore i ka të orientuara në rritjen dhe avancimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile, respektivisht me Organizatat Jo-Qeveritare.

<sup>1</sup> Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën 2016.

<sup>2</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Parashikimet e Popullsisë 2011-2061, varianti i mesëm, Prishtinë, 2014.

Prandaj, edhe kjo thirrje publike për përkrahje të projekteve të Organizatave Joqeveritare të cilat në programin e tyre janë të fokusuar në promovim dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës është në funksion të realizimit të proriteteve qeveritare në këtë fushë si dhe të rritjes së bashkëpunimit me shoqërinë civile për të promovuar, avancuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijës.

## 1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE

[Objektivi i përgjithshëm i kësaj Thirrje për Propozime është promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve]

Objektivi specifik i kësaj Thirrje për Propozime është: *Përmirësimi i aftësisë së OJQ-ve për të promovuar dhe mbrojtur të drejtave të fëmijëve dhe për të forcuar partneritetin dhe bashkëpunimin e Organizatave Jo-Qeveritare me akterët e tjerë, në veçanti me institucionet qeveritare që veprojnë në fushën e promovimit dhe mbrojtjes të të drejtave të fëmijës.*

Prioritetet për alokimin e fondeve:

- projektet të cilat kanë për qëllim forcimin e kapaciteteve të OJQ-ve për të punuar në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
- projektet të cilat janë të fokusuar në punë me grupet e fëmijëve, të rinjve, familje, shkollë, komunitet;
- projektet të cilat synojnë avancimin e bashkëpunimit në mes të OJQ-ve dhe institucioneve publike në përmirësimin e situatës së mbrojtjes së fëmijës dhe të drejtave të tyre;

## 1.3 VLERA PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTAL I THIRRJES

1. Për financimin e projekteve sipas kësaj Thirrje publike është paraparë shuma në dispozicion prej **xxx** euro.

2. Shuma minimale e financimit që mund të alokohet për çdo projekt individual është **xxx** euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **xxx** euro.

3. Projektet mund të financohen në shumën [e 100% ] të totalit të kostove të pranueshme të projektit. Aplikantët dhe partnerët potencialë [nuk është/është] nevojshme të sigurojnë bashkëfinancim nga burimet tjera (publike ose private) të financimit.]

## 2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

### 2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?

1. [në pjesën në vijim duhet të listoni format pranueshme të aplikantëve potencial dhe kushtet e detyrueshme (përfshitë zbatimin e duhur të kontratës, të qenit OJQ e regjistruar, punën aktive, etj).]

Aplikanti duhet të jetë:

1. Organizatë jo Qeveritare e regjistruar në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-Qeveritare,

2. Të ketë zotësi juridike, financiare dhe operacionale për zbatimin e projektit;

3. OJQ veprimtaria e të cilës është e fokusuar në mbrojtjen e fëmijës dhe të drejtave të tyre;

4. Të ketë kryer të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës

5. të mos jetë në proces falimentimi, në proces të shuarjes, në procedura të mbledhjes së detyruesh apo likuidimit;

6. të mos ketë shkelur kushtet e parashikuar të përdorimit të fondeve publike;

2. [në pjesën në vijim tregoni kush nuk mund të aplikoj dhe pse]

Nuk kanë të drejtë për të konkurruar sipas kësaj thirrje:

7. OJQ-të të cilat nuk i kanë shpenzuar mjetet nga mbështetja e mëparshme financiare publike për qëllimin për të cilin janë dhënë nuk kanë të drejtë konkurrimi (për dy vitet e ardhshme, duke llogaritur prej vitit në të cilin zbatohet projekti);

8. OJQ-të e falimentuara;

9. OJQ-të të cilat kanë dështuar të kryejnë detyrimet tatimore dhe kontributet tjera sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;

10. OJQ-të të cilat mund të kenë konflikt interesi;

3. [Tregoni se sa kërkesat mund të paraqiten nga i njëjti aplikant]

2. Një aplikant mund të paraqesë {një} aplikim/e.

3. Nëse aplikuesi dorëzon më shumë aplikime të projekteve që plotësojnë kërkesat e kësaj thirrjeje dhe janë të përshtatshme për financim, për nënshkrimin e kontratës do të përzgjidhen kërkesat me rezultatin më të lartë të vlerësuar.

4. Një aplikant mund të në të njëjtën kohë të jetë partner në {një} tjetër aplikim.

## 2.2 Partnerët e pranueshme në zbatimin e projektit/programit

1. [Shënoni nëse për zbatimin e projektit/programit është e detyrueshme apo e dëshirueshme të ketë partneritet me organizata tjera.

2. Aplikanti duhet të veprojë në partneritet me të paktën {një} OJQ e cila ushtron aktivitetin në rajonin/komunën ku zbatohet projekti;

3. Partnerët mund të marrin pjesë në më shumë se një aplikim.

3. [Shëno kushtet që duhet ti plotësojnë partnerët në projekt/program.].

Partnerët duhet të përmbushin të gjitha kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për aplikuesit, siç është paraparë në pikën e specifikuar në pikën 2.1 të këtyre udhëzimeve.

4. *[tregoni se si duhet të jetë i rregulluar raporti në mes të aplikuesit dhe partnerëve (nevoja për nënshkrimin e një deklarate të partneritetit) dhe që do të rregullojë marrëdhëniet në mes të ofruesit të mbështetjes financiare, aplikuesit dhe partnerëve (dmth, nënshkrimi i një kontrate përmes të cilës përcaktohen detyrat në zbatimin cilësor të projektit/programit, përdorimi efektiv i mjeteve dhe çështjet e raportimit të rregullt).]*

Me rastin e aplikimit, aplikuesi duhet të ketë arritur marrëveshje të partneritetit me OJQ-të partnere. Për këtë qëllim duhet nënshkruar një deklaratë e partneritetit, e cila duhet të dorëzohet në kopje origjinale të nënshkruar nga secili partner në projekt.

### 2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

1. *[tregoni kohën e arsyeshme të planifikuar për implementimin e projektit/programit]*

Kohëzgjatja e planifikuar e projekteve është midis {6} dhe {12} muaj.

11. *[tregoni territorin/zonën në të cilën synohet zbatimi i projekteve/ programeve, (psh. Gjithë territori i Republikës së Kosovës, ndonjë komunë specifike, disa komuna, një rajon etj.).]*

Aktivitetet e projektit duhet të kryhen në territorin e Republikës së Kosovës

12. *[Lista dhe llojet kryesore të aktiviteteve që do të financohen përmes thirrjes]*

Aktivitetet e pranueshme të projektit mund të përfshijnë:

- ✓ Aktivitetet që kanë për qëllim nxitjen e autoriteteve lokale, institucionet publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës;
- ✓ Aktivitete që synojnë avancimin e politikave qeveritare në fushën e mbrojtjes së fëmijës;
- ✓ Aktivitete mentorimi dhe trajnimi i stafit të OJQ-ve lokale që operojnë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijës;
- ✓ Aktivitete për përmirësimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive të punonjësve dhe vullnetarëve të OJQ-ve për avokim dhe fuqizimin e të drejtave të fëmijëve;
- ✓ aktivitetet që synojnë nxitjen e komunikimit të OJQ-ve me publikun, me fokus në informimin e publikut për të drejtat e fëmijëve;
- ✓ Aktivitete që synojnë adresimin e problemeve speciike të të drejtave të fëmijëve në sektor të caktuar të politikave prioritare qeveritare duke përfshirë, arsimin, politikat sociale, shëndetësinë, drejtësinë për të mitur dhe fusha tjera të ngjashme;

Lista e aktiviteteve të projektit nuk është e mbyllur, por vetëm ilustruese dhe do të merren parasysh për financim edhe aktivitete tjera të përshtatshme që kontribuojnë në arritjen e objektivave të përgjithshme dhe specifike të thirrjes, të cilat nuk janë të përmendura në listën më lart.

Gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit, aplikanti duhet të sigurojë që bazohet në parimin e ofrimit të mundësive të barabarta, barazisë gjinore dhe jo-diskriminimit, si dhe të zhvillojë veprimtari në përputhje me nevojat e komunitetit dhe qytetarëve.

4. [Tregoni se cilat aktivitete nuk janë të pranueshme për financim (psh. Aktivitetet përfitues të të cilave janë vetëm anëtarë të organizatës, etj)]

Llojet e mëposhtme të aktiviteteve nuk janë të pranueshme për financim:

- ✓ Aktivitetet të cilat kanë të bëjnë ekskluzivisht ose kryesisht në pjesëmarrjen individuale në seminare, konferenca dhe kongrese dhe punë kërkimore;
- ✓ Aktivitetet të cilat kanë të bëjnë ekskluzivisht ose kryesisht me bursa individuale për studime ose punëtori;
- ✓ Aktivitete të cilat nuk kanë të bëjnë me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
- ✓ Aktivitetet në të cilat përfitues të vetëm janë anëtarët e OJQ-së aplikuese;

## 2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

Përmes fondeve publike të kësaj thirrje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit/programit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

### 2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direkte përfshijnë shpenzimet që janë direkt të lidhura me zbatimin e disa aktiviteteve projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

- ✓ organizimi i aktiviteteve edukuese, tryeza të rumbullakëta (në mënyrë të veçantë duhet të identifikohet lloji dhe çmimi i secilit shërbim);
- ✓ material shpenzues;
- ✓ shërbime grafike (prepress, shërbimet për shtypjen e fletushkave, broshurave, revistave, etj, duke specifikuar llojin dhe qëllimin e shërbimit, sasinë, çmimin e njësisë, etj.);
- ✓ Shërbimet e reklamimit (televizionit dhe radio prezantime, mirëmbajtjes web faqeve, njoftimet në gazeta, materiale reklamuese, etj, duke përcaktuar llojin e promovimit, kohëzgjatjen dhe koston e shërbimeve);
- ✓ Shpenzimet e përfaqësimit që kanë të bëjnë me organizimin e aktiviteteve të projektit/programit (duke treguar qëllimin dhe numrin e pritshëm të pjesëmarrësve, etj);
- ✓ Shpenzimet e pagave dhe pagesave për menaxherët e projektit/programit, të kontraktorëve të projektit nga organizatat dhe/ose partnerët e jashtëm të përfshirë në projekt (kontratat e të drejtave të autorit dhe të drejtave pronësore, kontratat tjera, kontratat e punësimit), duke specifikuar emrin e personave të angazhuar, kompetencat e styre profesionale, numrin e muajve të angazhimit dhe shumën mujore bruto të kompensimit;
- ✓ Shpenzimet e komunikimit (shpenzimet e telefonit, internetit, etj) këto shpenzime duhet të jenë të përcaktuara (caktuara);
- ✓ kostoja për prokurimin e pajisjeve të nevojshme për zbatimin e projektit/programit, i cili duhet të jetë i përcaktuar nga lloji dhe shumën;

- ✓ shpenzimet e udhëtimit (p.sh., mëditjet );
- ✓ Shpenzimet për transportin dhe akomodimin (aty ku është e nevojshme duke e specifikuar numrin e njerëzve, destinacionit, shpeshtësinë dhe qëllimin e udhëtimit dhe llojin e transportit publik, llojin e akomodimit dhe numrin e netëve);
- ✓ kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e aktiviteteve të projektit apo programit;

#### 2.4.2 Shpenzimet e tërthorta të pranueshme

Përveç shpenzime të pranueshme direkte, në kuadër të kësaj thirrje do të pranohen edhe kostot indirekte (përqindje e vlerës totale të projektit/programit. Në kuadër të këtyre shpenzimeve përfshihen kostot që nuk janë të lidhura direkt me zbatimin e projektit ose programit, por janë kosto që në mënyrë të tërthortë kontribuojë në arritjen e objektivave të projektit. Edhe këto kosto duhet të specifikohen dhe të shpjegohen.

#### 2.4.3 Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë p.sh:

- ✓ investimet në kapital apo kredi për investime, fonde të garancisë;
- ✓ Kostot e blerjes së pajisjeve, mobiljeve, dhe punëve të vogla ndërtimore në qoftë se kalojnë vlerën prej 10% të totalit të kostove të pranueshme të projektit;
- ✓ Shpenzimet e interesit për borxhin;
- ✓ gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e procedurave gjyqësore;
- ✓ pagesa e bonuse për punonjësit;
- ✓ detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive, tarifat për transfertat financiare dhe tarifat e tjera krejtësisht të një natyre financiare;
- ✓ Kostot që tashmë janë të financuara nga burime publike apo shpenzime në periudhën e projektit të financuar nga burime të tjera;
- ✓ blerja e pajisjeve të përdorura, makineri dhe mobilje etj;
- ✓ kostot që nuk mbulohen nga marrëveshja (kontrata me ofruesin e mbështetjes financiare);
- ✓ donacionet bamirëse;
- ✓ kredi për organizata të tjera apo individ;
- ✓ kostot e tjera që nuk janë të lidhura direkt me përmbajtjen dhe objektivat e projektit;

### 3. SI TË APLIKONI?

*[në këtë pjesë të udhëzimeve duhet të listoni të gjithë informacionin mbi formularët e detyrueshëm, informacionin se ku duhet dërguar aplikimin, si dhe informacion në lidhje me afatet për aplikim dhe mënyrën e kontaktimit në rast se keni pyetje të tjera në lidhje me thirjen publike]*

Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i projekt-propozimit
2. Formulari i propozim buxhetit
3. Formulari i deklaratës së partneritetit
4. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të OJQ-së;

5. Kopja e Certifikatës së Numrit Fiskal;
6. Forma e deklaratës të mungesës së financimit të dyfishtë;
7. Forma e deklaramit të projekteve apo programeve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike të financimit;
8. Deklaratë e dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore;
9. Certifikatë nga Administrata Tatimore e Kosovës në lidhje me gjendjen e borxhit publik të aplikuesit dhe partnerëve që vërteton se organizata nuk ka borxh, dhe në rast se ka borxh publik, duhet të paguhet para nënshkrimit të kontratës. Certifikata duhet të jetë lëshuar brenda periudhës që nga data e hapjes së thirrjes publike (ky dokument do të kërkohet para publikimit të rezultateve përfundimtare, dhe pas publikimit të rezultateve preliminare);

### 3.1 Formulari i aplikacionit të projektpropozimit

Plotësimi i formës së projekt propozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ajo përmban të dhëna në lidhje me aplikusin dhe partnerët si dhe të dhëna mbi përmbajtjen e projektit/programit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike.

Në rast se në formën e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merren në konsideratë.

Nëse forma përshkruese përmban të meta si më sipër, aplikimi do të konsiderohet i pavlefshëm.

### 3.2 Përmbajtja e formës Buxhetit

Forma e plotësuar e propozim Buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Buxheti i dorëzuar duhet të përmbajë informacion për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të projektit/programit të propozuar për financim.

Nëse forma e buxhetit nuk është e plotësuar në tërësi, apo nuk është dorëzuar në formën përkatëse aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merret në konsideratë.

### 3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?

Format e detyrueshme dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të dërgohen në formë fizike, të shtypur (një origjinal) dhe në formë elektronike (në CD). Format e detyrueshme duhet të jenë të nënshkruara nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosura me vulën zyrtare të organizatës. Dokumentacioni në formë elektronike (në CD) duhet të ketë të njëjtën përmbajtje, pra të jetë identik me versionin e shtypur. Dokumentacioni i shtypur dhe ai elektronik në CD duhet të vendosen në një zarf të mbyllur.

Aplikimi origjinal duhet të dërgohet me postë ose në person (dhe të dorëzohet në Zyrën përkatëse). Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit dhe shënimin "*Të mos të hapet para takimit të Komisionit Vlerësues*"

Aplikacionet duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme:



[Zyra e Kryeministrit }

Sheshi Nëna Terezë, prishtinë, kati.xxx, Zyra n....]

"Të mos hapet para mbledhjes së Komisionit Vlerësues"

### 3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

Afati i thirrjes është xxx (ju lutem specifikoni datën, dhe në rast se kërkesa mund të paraqitet personalisht, atëherë ju duhet të specifikoni edhe orën). Kërkesa është dorëzuar brenda periudhës së thirrjes nëse vula pranuese tregon se është marrë në postë deri në fund të datës së thirrjes, si afati i fundit për dorëzimin. Në rast se kërkesa është paraqitur personalisht në Zyrë, aplikantit do ti lëshohet një vërtetim se aplikacioni është pranuar brenda periudhës së konkursit.

Të gjitha aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.

### 4.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike, duke i dërguar një kërkesë në adresën e mëposhtme: [xx@rks-gov.net](mailto:xx@rks-gov.net), jo më vonë se 10 ditë para skadimit të thirrjes.

Përgjigjet ndaj kërkesave të veçanta do të dërgohet direkt në adresën e pyetjeve të shtruara, dhe përgjigjet më të shpeshta do të publikohen në faqen e mëposhtme të internetit: [www.xxxx](http://www.xxxx), dhe jo më vonë se 5 ditë para skadimit të thirrjes

Për të siguruar trajtim të barabartë të të gjithë aplikantëve të mundshëm, një ofrues i mbështetjes financiare publike nuk mund të japë një mendim paraprak për pranueshmërinë e aplikantëve, partnerët, veprimet apo shpenzimet e përmendura në kërkesë.

## 13. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

### - Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:

4.1.1 Ofruesi i mbështetjes financiare do të themeloj një komision vlerësues të përbërë nga 3-5 anëtarë nga zyrtar të institucionit dhe ekspert tjerë të jashtëm, i cili ka për detyrë të vlerësoj aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.

Pas kontrollimit të gjitha aplikacioneve të pranuar, komisioni do të përgatis një listë të të gjitha aplikantëve që i plotësojnë kushtet për tu vlerësuar përmbajtja e projekteve të tyre, dhe një listë të aplikantëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të konkurrencës.

Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikantët të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.

4.1.2 Në fazën e dytë do të bëhet vlerësimi i përmbajtjes së aplikimeve nga ana e Komisionit vlerësues i përbërë nga 3-5 anëtarë. Çdo aplikacion i pranuar do të vlerësohet në bazë të formularit të vlerësimit.

[Mos harroni për ta futur këtu vlerësimin e formularit të aplikimit]

Lista e përkohshme e projekteve/programeve përfituese të përzgjedhura për financim - Në bazë të vlerësimit të aplikacioneve të cilat i kanë plotësuar kushtet e parashikuara të thirrjes, Komisioni do të hartojë një listë të përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura, sipas pikëve që ata kanë marrë në procesin e vlerësimit. Shuma totale e kosotos së projekteve të radhitura në listen e përkohshme nuk do të kalojë shumën totale të ofruar për financim përmes thirrjes publike.

Krahas listës së përkohshme, bazuar në pikat që janë bërë gjatë vlerësimit, Komisioni do të hartojë edhe listën rezervë të projekteve/programeve.

#### 4.2 Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi

Për të shmangur shpenzimet e panevojshme shtesë kur të aplikoni për konkurrencën, një ofrues i burimeve financiare do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikantë të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, ka hyrë në listën e përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës, dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, ofruesi mund të kërkojë shqyrtimin e formës së buxhetit për kostot e vlerësuara që korrespondojnë me shpenzimet aktuale në lidhje me aktivitetet e propozuara.

[Cekni këtu dokumentacionin shtesë që do të kërkohej (psh. Vërtetimin nga administrata tatimore se janë kryer të gjitha detyrimet tatimore, origjinalet e dokumenteve për inspektim, etj).]

Komisioni vlerësues do të bëjë kontrollimin e dokumentacionit shtesë.

Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës së caktuar (jo më pak se 10 ditë), aplikimi do të refuzohet.

Nëse pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse vendoset se disa nga aplikuesit nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara të thirrjes publike, nuk do të merret në konsideratë për nënshkrim të kontratës.

Në raste të tilla, projektet nga lista rezervë do të aktivizohen nëse, pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse dhe pasi të konstatohet nga institucioni se ka mjete të mjaftueshme për të kontraktuar projekte të tjera.

Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni do të propozojë listën përfundimtare të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

Njoftimi i aplikuesve - Të gjithë aplikantët aplikimet e të cilëve kanë hyrë në procesin e vlerësimit do të jenë të informuar në lidhje me vendimin për ndarjen e projekteve/programeve në kuadër të thirrjes.

## 14. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES

Fazat e procedurës së thirrjes (vendosni datat)

10. Afati i fundit për aplikimet
11. Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen
12. Afati i fundit për dërgimin e përgjigjeve për pyetjet që lidhen me thirrjen

13. Afati i fundit për verifikimin e përmbushjes së kriterëve procedurale dhe njoftimit të palëve
14. Afati i fundit për vlerësimin e aplikimeve në mënyrë përmbajtësore
15. Afati i fundit për kërkesën për dorëzimin e dokumenteve shtesë
16. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar
17. Afati i fundit për publikimin e vendimit për ndarjen e fondeve publike dhe njoftimi aplikantëve
18. Afati për kontraktim

Financuesi ka të drejtë të përditësoj kalendarin indikativ. Duhet të dini se çdo ndryshim në kalendarin indikativ do të publikohet në faqen e internetit e mëposhtme: [www.xxx](http://www.xxx).

## 15. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

### FORMULARËT

1. *Formulari i Aplikacionit për projekt/programit (word)*
2. *Formulari i Propozim buxhetit (format excel)*
3. *Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (format Word)*
4. *Formulari i kontratës kontratës (format word)*
5. *Formulari i Raportit Financiar (formatin excel)*
6. *Formulari i raportit narrativ-përshkrues (format word)*
7. *Formulari xxx*

## FORMULARI 5

### Logo e institucionit

Në bazë të Nenit 8, Par. 6, të rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, vendimit **Nr. Xxxx** për themelimin e Komisionit për Vlerësimin e Aplikacioneve të OJQ-ve për financim të projekteve/programeve të paraqitura në thirrjen publike (**emri i thirrjes**) të publikuar më ( \_\_\_\_\_ ), dhe në bazë të nenit Komisioni në takimin e parë të mbajtur më datë ( \_\_\_\_\_ ) miraton:

## RREGULLAT E PUNËS

të komisionit për vlerësimin e aplikacioneve të OJQ-ve për financim publik të projekteve/programeve sipas thirrjes publike (**emri i thirrjes**)

### Neni 1

#### Qëllimi i miratimit të rregullave

1. Rregullat e punës të komisionit për vlerësimin e aplikacioneve të OJQ-ve për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financim të projekteve/programeve sipas thirrjes publike do të rregullojë mënyrën e kryerjes së detyrave, të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të Komisionit, vendimmarrjen dhe çështje të tjera në kuadër të kompetencave të komisionit.
2. Komisioni do të punojë duke u bazuar në Rregullat në fuqi, në veqanti në bazë të rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

### Neni 2

#### Kompetencat e komisionit

1. Komisioni ka për detyrë të vlerësoj çdo aplikim nëse i plotëson ose jo kushtet e përgjithshme procedurale të përcaktuara me thirrjen publike dhe rregulloren mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Komisioni do të përgatis një raport për të gjitha aplikacionet e shqyrtuara nga komisioni duke listuar të gjitha aplikacionet dhe duke treguar nëse i plotësojnë ose jo kushtet kushtet e thirrjes publike.
3. Në fazën e dytë të vlerësimit, komisioni do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes të të gjitha aplikimeve në kuadër të thirrjes publike të cilat i plotësojnë kriteret formale për vlerësim përmbajtësor.
4. Komisioni vendos për ndarjen e detyrave brenda komisionit, dhe përcakton nëse secili nga anëtarët do të vlerësojnë secilin aplikacion apo do të bëhet ndarja e përgjegjësisve.
5. Edhe në rastet kur brenda komisionit ndahen detyrat, përgjegjësia e komisionit dhe vendimmarrja është kolektive.
6. Komisioni do të sigurojë që secili nga anëtarët të ketë ndarje dhe ngarkesë proporcionale me detyra në kuadër të komisionit.
7. Në rast se ndonjëri nga anëtarët e komisionit paraqet ndonjë konflikt interesi, atëherë komisioni duhet të shqyrtoj rastin e tillë dhe ti kërkojë udhëheqësit të institucionit zëvendësimin e tij. Në këto raste, deri në zëvendësimin e anëtarit në konflikt interesi, anëtari rezervë do ta zëvendësojë atë.
8. Tek vlerësimi i përmbajtjes së aplikacioneve, komisioni ka për detyrë të bëjë kalkulimin e pikëve përfundimtare për secilin nga aplikacionet e që do të llogaritet duke marrë përbazë pikët e secilit nga anëtarët e komisionit të mbledhura dhe të pjestuara për të për numrin e anëtarëve të komisionit për të nxjerrë pikët mesatare që do të marrë secili aplikacion.

9. Bazuar në vlerësimet e secilit projekt/program, komisioni për vlerësimin e aplikacioneve do të bëjë listën preleminare të projekteve/programeve të cilat do të financohen përmes fondeve publike.
10. Komisioni është përgjegjës për të bërë listën përfundimtare të përfituesve të projekteve të cilat do të mbështeten përmes fondeve publike dhe të njëjtën do e përcjellë për aprovim përfundimtar tek udhëheqësi/zyrtari më i lartë administrativ përgjegjës për fondet publike në kuadër të institucionit.

### **Neni 3**

#### **Detyrat e anëtarëve të komisionit**

1. Secili nga anëtarët e komisionit do të kenë për detyrë të vlerësojnë aplikacionet në aspektin procedural si në vijim:
  - 1.1. Të hapin çdo aplikim të paraqitur në kuadër të thirrjes publike dhe të bëjnë regjistrimin e përkatës të aplikacionit, duke përfshirë edhe vendosjen e numrave referues.
  - 1.2. Të analizojnë të gjithë dokumentacionin e paraqitur.
  - 1.3. Përcaktojnë nëse aplikimet i kanë përmbushur kushtet e konkursit, duke përfshirë edhe përdorimin e formave të standardizuara dhe plotësimin e tyre nga ana e aplikuesve.
  - 1.4. Të përcaktojnë nëse aplikantët i kanë dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara përmes thirrjes publike.
  - 1.5. Nëse është e nevojshme të kërkojnë nga aplikantët për të siguruar informacion/dokumentacion shtesë por që nuk ndikon në përmbajtjen e aplikacionit, si dhe kontrollimin dhe verifikimin e këtij informacioni/dokumentacioni shtesë.
  - 1.6. Të hartojnë dhe të nënshkruajnë procesverbalin e takimit duke përcaktuar nëse secili prej aplikimeve në mënyrë individuale i plotëson ose jo kushtet e thirrjes publike, mbi bazën e të cilit pastaj Institucioni përkatës do të përgatisë një njoftim me shkrim për aplikantët.
2. Secili nga anëtarët e komisionit do të kenë për detyrë të vlerësojnë përmbajtjen e aplikacioneve si në vijim:
  - 2.1. Të informohet me tekstin e thirrjes publike dhe të nënshkruajnë një deklaratë të paanësisë dhe konfidencialitetit.
  - 2.2. Të shqyrtojë dhe vlerësojnë përmbajtjen e projekteve dhe programeve të OJQ-ve aplikuese të cilat i kanë plotësuar kriteret procedurale. Vlerësimi duhet të bëhet sipas pyetjeve dhe formave të parapara me rregullativën juridike në fuqi.
  - 2.3. Të bëjë vlerësim të paanshëm, objektiv dhe pa ndikim nga subjekte tjera, duke shpjeguar me shkrim vlerësimin e tij, dhe duke iu referuar në shpjegimet e tij dokumentacionit të OJQ-së aplikuese, madje edhe duke cituar atë, dhe duke treguar pse pikërisht ka bërë atë poentim(vlerësim).
  - 2.4. Të vlerësoj koston e projektit për të formuar buxhetin e nevojshëm për impementimin e tij.
  - 2.5. Të identifikojë dhe vlerësoj përparësitë dhe mangësitë e çdo aplikacioni të vlerësuar.
  - 2.6. Të rekomandoj sigurimin e dokumentacionit shtesë nëse e sheh të nevojshme.

### **Neni 4**

#### **Përbërja e komisionit dhe detyrat e anëtarëve**

1. Komisioni për vlerësimin e aplikacioneve të OJQ-ve për mbështetje financiare publike të projekteve/programeve sipas thirrjes publike (emri i thirrjes) ka \_\_\_\_ anëtarë dhe kryesuesi i komisionit.
2. Kryesuesi e koordinon punën e Komisionit, duke përfshir edhe koordinimin e qëndrimeve për përgatitjen e raportit përfundimtar të Komisionit vlerësues.
3. Në rast të dorëheqjes së ndonjërit nga anëtarët e komisionit vlerësues, vendimn për aprovimin e dorëheqjes së tij e merr zyrtari kryesor administrativ i cili ka themeluar komisionin. Deri në aprovimin formal të dorëheqjes, anëtarët janë të detyruar të marrin pjesë në punën e rregullt të komisionit, përveç rasteve të konfliktit të interesit.
4. Në rast të dorëheqjes të ndonjërit nga anëtarët e komisionit, kryesuesi do të ftoj anëtarin rezervë për të marrë pjesë në vlerësim.

### Neni 5

#### Shmangia e konfliktit të interesit dhe mbajtja e konfidencialitetit

1. Çdo anëtar i Komisionit vlerësues është i detyruar që në fillim të nënshkruajnë një deklaratë të paanësisë dhe konfidencialitetit. Me nënshkrimin e Deklaratës, anëtarët e Komisionit konfirmojnë se detyrat e tyre në komision do trajtohen në mirëbesim, në mënyrë të paanshme dhe të pavarur, në mënyrë profesionale, objektive dhe në përputhje me parimin e shmangies së konfliktit të interesave. Po ashtu, ata pranojnë se do të trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjitha aplikacionet, duke i vlerësuar në përputhje me rregullat më fuqi.
2. Secili anëtarë i komisionit që ka informacion se ndonjëri nga anëtarët mund të ketë konflikt interesi, duhet që ta informojë komisionin menjëherë.
3. Anëtarët e komisionit vlerësues gjatë dhe pas përfundimit të punës së komisionit nuk kanë të drejtë të nxjerrin informacion në publik apo të informojnë ndonjërin prej aplikantëve mbi përmbajtjen e diskutimeve dhe vendimeve të marra përkitazi me aplikimet individuale, dhe nuk guxojnë të japin asnjë lloj informacioni i cili është i karakterit të brendshëm.
4. Emrat e anëtarëve të komisionit do të bëhen publik vetëm kur të publikohen rezultatet e thirrjes.

### Neni 6

#### Mbështetja teknike për komisionin vlerësues

Përkrahja administrative dhe teknike për të gjitha aktivitetet e komisionit që ndërlidhen me thirrjen publike duhet të sigurohet nga institucioni/njësia që ka hapur thirrjen publike.

### Neni 7

#### Hyrja në fuqi

Rregullat e punës së komisionit vlerësues janë miratuar në takimin/seancën e mbajtur më \_\_\_\_\_.

Kryesuesi i komisionit

\_\_\_\_\_  
(emri dhe mbiemri )

\_\_\_\_\_  
(nënshkrimi)

Anëtarët e komisionit

\_\_\_\_\_  
(emri dhe mbiemri )

\_\_\_\_\_  
(nënshkrimi)

\_\_\_\_\_  
(emri dhe mbiemri )

\_\_\_\_\_  
(nënshkrimi)

[Redacted]

(emri dhe mbiemri )

[Redacted]

(emri dhe mbiemri )

[Redacted]

(nënshkrimi)

[Redacted]

(nënshkrimi)

**FORMULARI 6**

Mostër e databazës së vlerësuesve(ekspertëve për anëtar t komisionit)						
Databazë e vlerësuesve / Emri i ofruesit të mbështetjes financiare						
Nr.	Emri dhe mbiemri i vlerësuesit	Të dhënat për kontakt	Numri i pikëve	Periudha e disponuesh mërisë	Thirrja publike për të cilën/cilat vlerësuesi është kontraktuar	Numri i aplikacioneve për vlerësimin
1.						
2.						
3.						
4.						
5.						
6.						
7.						
8.						
9.						
10.						
11.						
12.						
13.						



## FORMULARI 7

Logo e institucionit

Emri i ofruesit të mbështetjes financiare publike

### Forma e deklaratës së paanësisë, konfidencialitetit dhe shmangies së konfliktit të interesit

Unë, {vendos emrin} i nënshkruar si më poshtë, vërtetoj se unë si anëtar i komisionit vlerësues <shëno emrin e komisionit> të themeluar me vendimin nr. {numrin e referencës (nëse aplikohet) të thirrjes publike}, do të veproj në mirëbesim, në mënyrë të paanshme dhe në përputhje me parimin e shmangies së konfliktit të interesave dhe, prandaj, deklaroj se unë:

1. Do të mbaj në mënyrë konfidenciale të gjitha informatat që i posedoj;
2. Do të veproj vetëm në bazë të rregullave profesionale dhe objektive në përputhje me legjislacionin në fuqi;
3. Do të veproj në mënyrë plotësisht të pavarur, të paanshme dhe të barabartë për të gjitha propozim-projektet në procesin e përzgjedhjes, pa ndonjë ndikim të jashtëm;

<mund të shtohen edhe kushte tjera nëse është e nevojshme>

Në rast të paraqitjes së rrethanave që dëmtojnë ose mund të dëmtojnë objektivitetin dhe paanshmërinë time ose rrezikojnë parimin e shmangies së konfliktit të interesave, unë personalisht do të paraqes kërkesë për përjashtimin tim, dhe do të kërkoj nxjerrjen e vendimit nga organi kompetent për të më përjashtuar nga anëtarësia në komisionin vlerësues dhe nga procedura për ndarjen e mbështetjes financiare publike për OJQ-të.

Duke pas parasysh **dënimin për dëshmi të rreme**, Unë vërtetoj si më larë dhe **jam i vetëdijshëm se në rastin e deklaratave apo informacioneve të rreme** do të aplikohen dënimet dhe sanksionet përkatëse.

Në <vendos vendin> datë: \_\_\_\_\_ 2017

<Vendos emrin e anëtarit të Komisionit >

\_\_\_\_\_ <vendos nënshkrimin>

**FORMULARI 8**

Forma e mostrës për vlerësimin e kandidatëve për (vleresues) anetare te komsonit vleresues(per ekspertet e jashtem)									
Nr.	Emrin dhe mbiemrin e kandidatit për vleresues(ekspert)	Emri dhe mbiemri i anëtarëve të Komisionit për vlerësimin e kandidatëve për anetare te komisionit vleresues							
		Një person i plotësqn kërkesat e	1. Përvoja në përgatitjen dhe / ose zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike (20)	2. Përvoja në vlerësimin e kërkesave të paraqitura në thirrjet për mbeshtetje financiare nga burimet publike (10)	3. Njohja e dokumenteve strategjike dhe politikave prioritare ne fushen e thirrjes publike (15)	4. Njohja e bazes ligjore në fuqi në ne fushat qe mbulon thirrja publike (10)	5. njohja e metodologjive ekzistuese sektoriale në fushën në e thirrjes publike (20)	6. Njohja e dokumenteve të tjera relevante në fushën në të cilën eshte hapur thirrja publike (10)	7. njohja e gjuha se institucioneve kryesore dhe qëllimit te tyre te punës në fushat në të cilat eshte hapur thirrje publike (15)
1.									
2.									
3.									
4.									
5.									
6.									
7.									

## FORMULARI 9

[Emri (dhe logo) i ofruesit të mbështetjes financiare

### Emërtimi i thirrjes publike:

### Aplikacion për projekt/program

Data e publikimit të thirrjes: data

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit: data:

Ju lutemi para se të plotësoni Formularin për [Emri i thirrjes publike] lexoni me kujdes udhëzimet për dorëzim.  
Forma duhet të plotësohet me kujdes dhe sa më qartë që të jetë e mundur në mënyrë që të mund të bëhet një vlerësim sa më i mirë i cilësisë së projekt-propozimeve. Informatat duhet të jenë të sakta, të plota në mënyrë që të japin detaje të mjaftueshme për të kuptuar në mënyrë të qartë projektpropozimin.

Emri i aplikuesit: \_\_\_\_\_

## I. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR APLIKUESIN E PROJEKTIT DHE PARTNERËT

### INFORMACION BAZË PËR ORGANIZIMIN E APLIKUESIT DHE DHE PARTNERËVE

1. Emri i organizatës			
2. Adresa (rruga dhe numri)			
3. Kodi postar dhe selia	4. Rajoni		
5. Emri i përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së, adresa, e-mail dhe funksioni aktual (p.sh. Drejtor Ekzekutiv)			
6. Nr. Tel.	7. Nr. Tel. Mob.		
8. Fax			
9. Adresa postare			
10. Faqja e internetit			
11. Viti i themelimit			
12. Data e regjistrimit në regjistrin e OJQ-ve	13. Numri i Regjistrimit të OJQ-së		
14. Regjistruar në (emri i organit të regjistrimit)			
15. Numri llogarisë bankare përfshirë IBAN			
16. Numri fiskal			

17. Lloji i OJQ-së (shoqatë/fondacion)			
18. Objektivat e krijimit në përputhje me statutin e OJQ-së			
19. Qëllimi dhe fushëveprimi			
20. Numri i përgjithshëm i (vendoset numëri)	Anëtarëve		
Nga ta (vendoset numëri)	Individ		Persona juridik
21. Pjesa e punës vullnetare në organizatë			
a) numri i atyre të cilët punojnë vullnetarisht			
b) numri i orëve të punës vullnetare arritur në vitin para shpalljes së thirrjes			
22. Numri i të punësuarve në ditën e dorzimit të projektit (vendoset numëri)	Të punësuar për kohë të kufizuar		Për një kohë të pacaktuar
23. A është organizata juaj përfituese e statusit të beneficuar publik	Po.		Jo.
24. Totali i të ardhurave të organizatës në vitin para shpalljes së thirrjes publike (vendosni shumën)			
25. Të ardhurat janë realizuar (shëno shumën)			
a) Burimet publike qendrore (ministritë dhe agjencitë qendrore qeveritare)			
b) Burimet publike komunale			
c) qeveritë e huaja dhe organizatat ndërkombëtare			
d) kompanitë dhe personat e tjerë juridikë			
e) qytetarët dhe familjet			
f) organizatat tjera Jo-qeveritare			
g) të ardhurat nga kuotat e anëtarësisë			
h) Të ardhurat nga fondet e BE-së			
26. Shuma totale e paguar për paga në vitin para shpalljes së thirrjes publike			
27. Shuma totale e paguar në të ardhura të tjera në vitin para shpalljes së thirrjes publike			
28. Informacion në lidhje me hapsirën në të cilën vepron OJQ			
a) Hapësira e vet ( trego madhësinë në m2)			
b) Hapësira me qira (trego madhësinë në m2)			

c) Hapsira e komunës/ Qeverisë/ndërmarrjes publike/ (shëno madhësinë në m2 dhe shumën e qirasë mujore)				
29. Shuma e përgjithshme e mbështetjes financiare publike në vitin para shpalljes së thirrjes				
30. Numri i partneriteteve në të cilat organizata është e përfshirë në zbatimin e projekteve / programeve të aplikojnë në këtë thirrje publike				
31. A përgatit OJQ-ja juaj raport vjetor pune? (vendosni një "x")	Po.		Jo.	
a) Nëse jeni përgjigjur me "po" kujt i është dorëzuar dhe si ia keni paraqitur publikut?				
32. A keni shpenzuar në sistemin e cilësisë për organizatat jo-fitimprurëse?	Po.		Jo.	
a) Nëse jeni përgjigjur me "po" cilin sistemin dhe deri kur?				
<p>33. Njohja e aplikantit (apo partnerëve) përmes projekteve të financuara nga burimet publike të financimit gjatë viteve paraprake (Ju lutem specifikoni projektet/ rogramet e financuara nga burimet publike të financimit, duke përfshirë edhe emrin e institucioneve/ofruesve të mbështetjes financiare publike nga të cilat ju keni pranur mbështetje financiare gjatë dy viteve të fundit para shpalljes së kësaj thirrje publike.</p>				
<p>34. Jepni informacion mbi organizatat partnere, nëse projekti/programi do të realizohet në partneritet: (nëse është e nevojshme, shtoni rreshta të reja)</p>				
<p><b>1. ORGANIZATA PARTNERE</b> (nëse është e nevojshme të shtohet më shumë informacion për partnerët)</p>				
<p>Emri i Organizatës: Adresa (rruga dhe numri): Qyteti: Rajoni Emri i përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së, adresa, e-mail dhe funksioni aktual (<i>p.sh. Drejtor Ekzekutiv</i>) Telefoni fiks: Telefoni Mobil: Faksi: E-mail Adresa: Faqja e internetit: Viti i krijimit:</p>				

Numri i regjistrimit të OJQ-së:  
Numri Fiskal:  
Data e regjistrimit në regjistrin e OJQ-ve  
Lloji i OJQ-së (shoqatë/fondacion)  
Objektivat e krijimit në përputhje me statutin e OJQ-së  
Qëllimi dhe fushëveprimi  
Numri i të punësuarve:  
Shuma e përgjithshme e mbështetjes financiare publike në vitin para shpalljes së thirrjes (si dhe numri i projekteve të financuara nga burimet publike)  
Organizata vepron:  
a) Hapësira e vet ( trego madhësinë në m2)  
b) Hapësira me qira (trego madhësinë në m2)  
c) Hapësira e komunës/  
Qeverisë/ndërmarrjes publike/  
(shëno madhësinë në m2 dhe shumën e qirasë mujore)

## II. INFORMACION MBI PROJEKTIN / PROGRAMIN

1. Emri i projektit /programit:
2. Organi i OJQ-së që ka miratuar projektin dhe data e miratimit të tij
3. Përmbledhje e projektit/programit ( një prezantim i shkurtër i informacionit bazë për projektin/programin në jo më shumë se 50 fjalë)
4. Kohëzgjatja e pritur e implementimit të projektit/programit në muaj:
5. Fusha në të cilën do të implementohet projekti/programit (ju lutem specifikoni fushën e veprimit social dhe politikat publike në të cilat projekti/programi do të aplikohet)
6. Rajoni gjeografik në të cilin do të implementohet projekti/programi
  - a) Republika e Kosovës (nëse projekti/programi implementohet në gjithë territorin e Kosovës

b) Rajoni/rajonet( tregoni rajonin ose rajonet në të cilat do të implementohet projekti	
c) Komunakomunat(shëno komunat përkatëse)	
7. Shuma totale e kërkuar për zbatimin e projektit/programit:	
7.1. Shuma totale e kërkuar për financim nga donatorët; në ___% e shumës për implementimin e projektit/programit	
7.2. A është shuma e kërkuar apo e siguruar nga burimet publike (institucionet qendrore apo lokale, fondet e Bashkimit Evropian apo nga donatorë të tjerë për zbatimin e këtij projekti (specifiko shumat totale për aplikantët dhe partnerët nëse ata kanë dhe shtoni rreshta nëse është e nevojshme)	
Po.	Jo.
Nëse përgjigja e pyetjes së mëparshme është “po” tregoni se sa është kërkuar dhe miratuar nga sa çdo financim i donatorët (shtoni rreshtat e reja nëse është e nevojshme):	
Nga ata që është kërkuar:	Shuma e fondeve të kërkuara:
Nga ata që është siguruar	Shuma e fondeve të miratuara:
8. Ju lutem tregoni mënyrën se si keni ardhur deri tek identifikimi i problemit dhe vlerësimi i nevojave që keni ndërmend të adresoni përmes këtij projekti, bazuar në të cilat ju keni përgatitur këtë propozim të projektit/programit?	
9. Lista e përshkruajnë objektivat e synuara të arrihet përmes zbatimit të projektit / programit të propozuar.	
10. Përshkruani ndikimet e pritshme të projektit/programit – atë se si projekti do të ndikojë në grupin e synuar dhe përdoruesit përfundimtarë në një periudhë afatgjate.	
11. Përshkruani rezultatet e matshme që ju i prisni në fund të zbatimit të projektit/programit tuaj.	
12. Shpjegoni se në arritjen e cilave objektiva të përgjithshme dhe specifike të thirrjes publike do të kontribuojë implementimi i këtij projekti dhe si.	
13. Një përshkrim i detajuar i projektit/programit (max 2500 karaktere)	
14. Cili është grupi i synuar (grupi në të cilin aktivitetet e projektit/programit do të ndikojnë direkt) i përfshirë në projekt, duke përfshirë numrin dhe strukturën e tyre (p.sh., mosha, gjinia, etj)? Si janë ata të përfshirë në këtë projekt? (Ju lutem specifikoni problemet dhe nevojat e grupeve të synuara, duke përfshirë edhe treguesit sasiorë dhe se si projekti do të arrijë grupin e synuar)	
15. Kush janë përfituesit përfundimtarë të projektit (individët, grupet, organizatat që nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin e projektit, por që implementimi i projektit do të ketë tek ata një efekt të tërthortë)? Si do të ndikojë projekti tek ato grupe? (Ju lutem specifikoni):	

16. Përshkruani, aktivitetet kryesore që do të kryhen në kuadër të projektit, bartësit, rezultatet e pritura, periudha e zbatimit të tyre, metodat që do të përdoren në zbatimin e projektit (nëse është e nevojshme shtoni rreshta në tabelën e mëposhtme).

Aktivitetet	Bartësi	Metodat implementuese	Periudha e implementimit	Rezultatet e pritura
1.				
2.				
...				

17. Listoni aktivitetet më të shpeshta që kryhen në projekt/program.

18. Ju lutem tregoni se cili lloj i aktiviteteve të tjera do të kryhet në kuadër të projektit/program.

19. Plani i veprimit - të sigurojë emrin e aktiviteteve dhe të nxjerrë në pah, kur do të zbatohet aktiviteti dhe organizata që është përgjegjëse për zbatimin e tij (organizata aplikuese, ose partnerët) (nëse është e nevojshme, zgjeroni tabelën).

Gjysma e parë e projektit

Aktiviteti	Muaji i zbatimit	1	2	3	4	5	6	Organizata përgjegjëse
Aktiviteti xyy								
...								

Gjysma e dytë e projektit:

Aktiviteti xy	Muaji i zbatimit	7	8	9	10	11	12	Organizata përgjegjëse
...	...	...	...	...	...	...	...	...

Gjysma e dytë e projektit xy:

Aktiviteti xy	Muaji i zbatimit							Organizata Përgjegjëse

20. Personat përgjegjës për zbatimin e projektit / programit

a) Udheheqesi/drejtuesi i projektit / programit (shkruani emrin dhe bashkangjitni një CV)	
b) Kontraktorët (shkruani emrin, përshkrimin e përvojës dhe kualifikimeve të mëparshme)	
21. Numri i vullnetarëve që marrin pjesë në projekt / program (specifikoni numrin e vullnetarëve dhe numri i orëve vullnetare të parashikuara në projekt /	



- program)
22. Përshkrimi i aktiviteteve të cilat vullnetarët do të kryejë për zbatimin e projektit (për secilën kategori dhe llojin e punës vullnetare)
  23. Numri i personave të punësuar të përfshirë në zbatimin e projektit / programit (specifikoni për të gjitha organizatat)
  24. Ekspert /et, bashkëpunëtorët / e jashtëm të cilët janë përfshirë në projekt / program (shëno emrin dhe fushat e ekspertizës)
  25. Përshkrim i shkurtër i përvojave, arritjeve dhe aftësitë e organizatës - aplikanti në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me partnerin. (specifiko aktivitetet/projekteve / programeve të mëparshme dhe të tanishme të cilat organizata aplikuese dhe partnerët kanë zbatuar, në veçanti të ndërlidhura me thirrjen publike

26. A është kryer projekti/programi në partneritet?

.

27. Përshkruani rolin / kontributin e organizatave partnere në zbatimin e projektit / programit.

28. Si do të siguroni transferimin e njohurive dhe aftësive specifike ndërmjet organizatave partnere në projekt / program?

29. Si planifikoni realizimin e aktiviteteve të projektit / programit për të përfshirë promovuesit / pranuesit / zbatuesit e politikave publike (në nivel lokal, apo nacional)?

30. Përshkruani se si keni ndërmend të përfshini qytetarët në projekt / program dhe për të informuar publikun e gjerë për të arriturat dhe rezultatet e projektit / programit.

### III. VLERËSIMI I REZULTATEVE

1. Përshkruani rrugën që do të bëjë monitorimin dhe vlerësimin e arritjeve të rezultateve të projektit / programit dhe ndikimin e tij në përmbushjen e objektivave të thirrjes publike.

### IV. QËNDRUESHMËRIA PROJEKTIT / PROGRAMIT

1. Përshkruani planet tuaja që do të sigurojnë qëndrueshmërinë e projektit/programit pas përfundimit të mbështetjes financiare publike (financiare, institucionale, në nivelin e zhvillimit të politikave dhe qëndrueshmërisë së mjedisit të aktiviteteve të projektit/programit pas përfundimit të projektit)?

---

**Emri dhe mbiemri i udhëheqësit /  
menaxherit të projektit / programit  
(në organizatë - aplikuesit)**

---

**Nënshkrimi**

---

**Emri i përfaqësuesit të autorizuar  
në organizatë - aplikuesi)**

---

**Nënshkrimi**

Në \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ 201\_.

FORMULARI 10					forma e buxhetit	
<div style="border: 1px solid black; padding: 5px; margin-bottom: 5px;"> <p><i>(LOGO) e ofruesit te mbeshtetjes financiare publike</i></p> </div> <p><b>Emri i OJQ-se:</b></p> <p><b>Titulli i projektit:</b></p> <div style="background-color: #f4a460; padding: 5px; margin-top: 10px;"> <p>Forma e buxhetit te thirrjes publike</p> </div> <p style="text-align: center; margin-top: 10px;">Ju lutemi plotësoni formularin me kompjuter. Nëse është e nevojshme mund te fusni kolona shtese, por mos harroni të kontrolloni vlefshmërinë e formulave. Formulari do te kalkuloj shumat sipas formulave dhe nuk është e nevojshme te kalkulohen ne menyre manuale</p>						
<b>Lloji i kostos</b>	<b>Cmimi per njesi</b>	<b>Buxheti i përgjithshëm i projektit në euro</b>	<b>Buxheti i kerkuar nga ofruesi i mbeshtetjes financiare publike (në euro)</b>	<b>Viti 1 (për të shtuar një kolonë për çdo vit nëse është e nevojshme )</b>	<b>SHPJEGIMI I ZERAVE BUXHETOR - llogaritja e çmimeve për njësi dhe kostoja totale, dhe një listë të aktiviteteve për të cilat zbatohet paragrafi</b>	
A) Kostot direkte (specifiko shpenzimet që janë të lidhura direkt me projektin)						
1. Burimet Njerëzore						

